

INTERVISTË ME ISUF PECIN

Stantërg | Data: 17 maj, 2021
Kohëzgjatja: 111 minuta

Të pranishëm:

1. Isuf Peci (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Besarta Breznica (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Isuf nëse mundeni me u prezantu, data e lindjes, diçka për familjen, prejardhjen e ju?

Isuf Peci: Une quhna Isuf Peci, jam nga fshati Boletin. Une jom rritë, jom lindë edhe jom rritë në fshatin Boletin. Rrjedhi nga një familje mesatare. Shkollën fillore e kom kry në fshatin Boletin, “Isa Boletini”, shkollën fillore në “Isa Boletin”. Kurse të pestën, gjashtë, shtatën dhe të tetën, fëmi i vogël jom konë me kushte shumë të fshtira, e kom kry në shkollën “Muharrem Bekteshi” te ura e Ibrit në Mitrovicë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë jeta e ju në familje si fëmi?

Isuf Peci: Ka qenë si e çdo fshatari atëherë me thonë të vërtetën, ka pasë kujtime atëhere, edhe atëhere e maj në mend si fëmi kena pasë presione, kena pasë. Meqenëse, fshati gjendjen në këtë komunën, prej kur është bo ndamja në Komunën e Zveçanit, në territor të Zveçanit, këtë komunën e tashme. Kurse edhe atëherë ka qenë pak zullum, për shembull, domethënë atëherë kena pagu edhe tatim shtetit, kena pagu edhe qysh me thonë tash, përpara i kena thonë *utrina*¹ që atë shtazët tona që e kanë hongër atë toke të shtetit edhe ata e kena pague. E kena qenë ni familje mesatare, baba, babai im ka punu në një sipërmarrje të ish, të Krlevës “Kabllar”, të Krlevës deri në pension veç për me na majt neve fëmive edhe kështu, deri sot që jena ardh qishtu.

Anita Susuri: Më tregut për babën e ju që e ka kry një punë të rëndësishme në atë ndërmarrje që ka punu.

Isuf Peci: Ka qenë punëtor i thjeshtë me thonë të vërtetën, se nuk ju ka dhonë hapësirë këtyne. Ka punu në teren, ka punu edhe këtu, ka punu në Mojkovc, ka punu në Krlevë, ka punu... ku ka pasë

¹ Toka komunale, rurale që përdoret për kullotjen e bagëtive; tokë e lënë pas dore, e papunuar.

rindërtim, ndërtimor. Sa që e kena edhe rastin që i ka kry këto banesat në Tunel të Parë, krejt i ka kry “Kabllari” Krlevës. Ka punu punëtor i thjeshtë.

Anita Susuri: Në cilat vite jonë bo këto banesat, jonë bo për minatorë?

Isuf Peci: Po jonë bo për minatorë. Nuk e di valla, ka 70 vjet, 75 vjet gati, a s’di sa që jonë ndërtu. Nashta gaboj, po s’di në cilin vit jonë asi këto.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet tjetër, ju jeni konë domethonë me një, me një fshat, Boletini osht’ edhe fshati i Isa Boletinit...

Isuf Peci: Po, po.

Anita Susuri: Edhe a jeni rritë në qasi fryme, ndoshta patriotike? Edhe po thoni që keni pasë presione, qysh e kujtoni ju qeto, çfarë fshati ka qenë?

Isuf Peci: Fshati Boletin edhe në histori edhe në sytë e ish sistemit komunist gjithë kena qenë në sy. E maj në mend që prej fëmi kur kom qenë në nivel të komunës, edhe në nivel regjioni nashta të Kosovës, pesë killometra se e kem tre killometra e gjys Zveçanin, nuk kena pasë elektrifikim të rrymës. Qat’ gjendje jena konë, a din nër presion, nuk na kanë dhonë kurrfarë të drejtash, kurgjo. Edhe çka o ma e keqja ka qenë kisha aty, afër shumë është kullës kisha, edhe aty ajo kisha sot e atë ditë është. Sherrin ja kena pa gjithë, aty kanë nejt edhe kriminelat, po foli tash, nashta po keq shumë, në kohën e luftës ka nejt Arkani, e këta kriminelat aty kanë bo, kanë flejt, kanë asi. Po flitet se ajo kisha diku në një mijë e... u formu, osht’ me 1832-tën, mos gabofsha, aty u vendos ajo kishë edhe ajo kishë flitet se hymjen e ka pasë, simas të dhanave po këta ja kanë rue, osht’ kishë katolike, po këta e kanë shndërru në kishë pravosllave [ortodokse].

Anita Susuri: E juve si fëmi a ju kujtohet që keni shku anej, keni shku te kulla, a ju kujtohet?

Isuf Peci: Te kulla?

Anita Susuri: Si fëmi a keni shku najherë m’i pa qato, m’i vizitu? Ose me lujt te kulla, te...

Isuf Peci: Ku, në kishë po menon?

Anita Susuri: Kishë, kullë.

Isuf Peci: Po jom hi. Kur jom kon fëmi jom hi, aty jom hi e para e herë kur jom konë fëmi edhe aty kur ka qenë, i kanë thonë tyneherë sabor i kanë thonë, kur mledhën sërëbët savori. Sikur është rasti në, në...

Anita Susuri: Gazimestan.

Isuf Peci: Në Gazimestan që osht', i kanë ato datat e veta jom hi si fëmi, s'më kanë diktue hiç edhe jom hi mrena aty. Edhe kur jom hi mrena e kom pa nifarë hapsine ka pasë asi qira tyne të sahrut, i ardhke nifarë ere, shumë e ronë u konë ajo erë. Po flitet, osht' shumë interesant se, mos koftë prej gojës tem, *subhanallah*, ishalla nuk o gjyna, ajo kishë ma s'pari u konë në Mazhiq, e prej Mazhiqi u ardh në Trepçe qitu. E në Trepçe kaçakët tynehere që i kena thonë na, simas tonëve që thojnë të moçmit, në atë kishë jane ardhë kaçakët i kanë thonë, "Çka po don këtu ti?" Atina i kanë thonë edhe i kanë mshu shpat. Bile qajo Bogorodica [statuja e Shën Marisë] që i thojnë, si Zot e majnë ata që besojnë në to, e ka të hiqt këtu {prek me gisht hundën}, e ka hunën e hiqt, {bën sikur lëviz shpatën} kur i ka mëshu shpat. E ka marrë ai ato edhe u ardhë në Boletin.

E kur u ardhë në Boletin ju ka lut babës të Isës, Ademit, i ka thonë, "A bon..." po ai ish konë me fakulltet ai që u konë në qat' gjendje, u konë i shkollum për qaso, u konë diplomat a kush e di. I ka thonë, "A bon..." e ka shti në gjyna ka thonë, "Me shti qeto qitu e po bona rrogtar". Ai u konë rrogtar i Isës i babës të Isës, ai sërbi. Bile aty është ni kërrsh shumë i madh, nashta ju vjen rasti atje me shku me qyrr, osht' ni kërrsh, osht' ni shpellë rrafsh sa qekjo dhomë osht' këtu, ka thonë, "Qitu po rri". Po ai e ka pasë me sherr, se politika serbe gjithmonë, gjithmonë osht', qaq propagand e fortë që me anë të lisave, me anë të kodrave, me anë të kërrsheve, gjithmonë qyrrin me rritë historinë e vet, punojnë në njifarë mënyre me shkencë ata.

Edhe e ka shti qaty, mas ni kohe u konë rrogtar i Isës, i babës të Isës edhe u hi rrogtar e ka pagu, i ka thonë, mas ni kohe i ka thonë, "A bon me maru ni shpi" të vogël m'u lut" ka thonë, me këto se edhe unë e kom fenë tem, po lutna në to. Po nuk ja kanë, ai Isa, në atë kohë u konë fuqi. Ka thonë, "Ajt s'ka problem", po ai e ka pasë ni politikë shumë të keqe. Edhe tu u rritë, tu u rritë sot i ka s'di sa hekterë aty tokë. Sa që e ka nxonë udhën, e ka nxonë udhën e dyqin vjete që u konë prej tu shkolla e tash u maru, nër kullë që e ka maru nona e Isës, axha e atje u dalë tash, e kanë nxonë kisha. Krejt e ka shti atë pjesë, nashta ju ka ra rasti e ka shti në *zid* [muri]. Edhe krejt e ka shti në *zid* e ka ndriçu.

Anita Susuri: Kjo osht' si legjendë qysh u bo qajo, a po?

Isuf Peci: Po, po, po. Ajo osht' nifarë mënyre, tajshi masi u bonën këto tollovitë tona, u bo komuna se Zveçani u konë, zyre për komunitete, *mesna zajednica* [srb.: bashkësi lokale] i kanë thonë sërabisht. E tash, tash kur na qitën neve knej e bonën komunë në veti Zveçanin edhe e kanë bo Komunën e Zveçanit po edhe e kanë bo Zubin Potokun. Se as Zubin Potoku s'u konë, i maj në mend këto. Zyre e vendit u konë Zveçani edhe u bo, neise Leposaviqi u konë. Edhe tash njifarë mënyre me këtë planin e Ahtisarit që po thojmë na, që po e thirrur, tash jena metë na Boletini, Lipa tash quhet, Kelmendi dhe Zhazha edhe Suhodolli ni pjesë, ato jonë metë... po Suhodolli në atë anë nuk po pranojnë me konë nër

Komunë të Zveçanit. Kurse na Boletini, Kelmendi e Zhazha kena metë, sot e atë ditë jena metë në qat' komunë, deshte s'deshte.

Anita Susuri: Ju i përmendët edhe do *sabor* që i kanë thonë këta...

Isuf Peci: *Saboret*, po, po, po, po.

Anita Susuri: A ju kujtohen, po më doket ka qenë, ka pasë edhe muzika, ka pasë...

Isuf Peci: Po ka pasë muzika, ka pasë, me thonën të vërtetën...

Anita Susuri: Për fëmi loja...

Isuf Peci: Po, po, ka pasë muzika, loja, po ma së rreziku u konë ni rast më kujtohet mue, baba jem i ndjerë... kanë nejt aty ka ni ditë e dy në kishë e kanë pi shumë alkohol edhe ni rast ka ndodh, trupi po më rrënoqethet, jom konë fëmi i vogël (qan) kishin pasë pi ata shumë, tana na sulmun aty. Hinën në shpi e u tutëm na (qan).

Anita Susuri: Kur jeni konë ju fëmi?

Isuf Peci: Po, fëmi kur jom konë.

[Këtu ndërpritet intervista]

Isuf Peci: Tanaj ni sërbi i Grabovcit, tha, "Mos e asini..." na sulmoi aty. Kapërcejshin asajde e kanë pasë rrugën edhe baba jem i ndjeri e kapi sakicën (qan) {fshin lotët}. E kapi sakicën tajshi u bo nifarë tollovie, na hinum mrena aty e kapërcyen. E po du me lidh se sa herë kanë pasë *sabore* gjithë kena pasë frikë prej tyne, se jena konë në kufi me ata aty. A din edhe s'ka pasë njeri, fëmi i joni që, që u rritë në ato tri fshatra që nuk e kena ditë gjuhën me ta, se jena konë, tokat i kena pasë ngat aty. A din, edhe, edhe kur u bo lufta nuk jom konë këtu, qashtu ma ka sulmu motrën, natën ma kanë rreh, e dinë edhe këtu në Mitrovicë, kur ke kjo lufta e mram.

E qashtu po du me lidh që gjithmonë kena hekë prej tyne, gjithmonë sa u konë historia e shkrume. Gjithmonë kena hekë për shkak se kur jonë konë do tontë në kohën e Isës, atëherë e kena pasë ni fuqi edhe kur u konë ish familjar i joni, i ndjeri Pajazit Boletini ka qenë xhandar i xhandarmërisë të... në atë kohë kur ka sundue gjermani, tri vjet ai u konë xhandar, qaq fuqi ka pasë që ka pasë lidhje me gjerman edhe u konë shumë i aftë. Në atë kohë e kena pas ni rrit, po tanaj edhe na ju kena hakmerr sërbeve në atë kohë. Osht' e vërtetë nuk i kena harru ato hekjet që na i kanë kujtu neve edhe na tanishi ju kena hakmerr sa e kena pas pak forcën tonë.

Anita Susuri: Deshta me thonë ju... ma herët qysh na kanë tregu kulla po më duket ka qenë edhe si shkollë? A keni shku edhe ju në atë shkollë?

Isuf Peci: Po aty i kom krye katër vjet, une jom konë në dy dhoma, ku sot osht' muze edhe shpesh kur shkoj, unë e di edhe bankën ku jom konë, e di edhe salla arsimtarëve ku u konë. Shumica jonë dekë, vetëm njo osht' gjallë, osht' Asllan Kelmendi edhe aty e kom kry shkollën u konë kullë qaty na patën leju për me asi, ka shumë kuadra të forta sot.

[Këtu ndërpritet intervista]

Isuf Peci: Po aty, aty jonë konë katër ose nashta jeni konë najherë në kullë, jonë konë... na kanë dhonë atëherë kur e kom kry shkollën, kurrë nuk e harroj na qitshin tomël, *prašak* [srb.: pluhur] të Amerikës i thojshin, e vlojshin aty na dhoke kurrilat, ajo dyje u konë jetë, jetë...

Korab Krasniqi: E shkolla që osht' tash, a ka qenë atëhere apo...?

Isuf Peci: Kulla, në qat' kullë une e kom krye, po tash e kanë maru shkollën, kështu qysh...

Korab Krasniqi: Mrapa.

Isuf Peci: Mrapa saj, po, po.

Anita Susuri: E qysh...

Isuf Peci: Une, une e kom zatet edhe në kullë që e kom kry shkollën, tash ku o shkolla tash e marume u konë shtalla, ato që e ka pasë Isa Boletini, ato që e ka pasë mallin e vet, fuqinë e vet që e kanë pasë, qashtu jonë konë të pasun, po. Atë shtallën e drunit kurrë s'e harroj (buzëqesh).

Anita Susuri: E qysh u konë ajo kulla, po menoq qysh jonë konë të ndame klasët?

Isuf Peci: Përpara u konë hymja, tani në hymjë aty jonë konë katër oxhakë, s'di a e din çka jonë oxhakët {përshkruan me duar}, që qesin ktyneherë, shumë të bukra...

Anita Susuri: Si kamin.

Isuf Peci: Po. Aty jonë katër oxhaqe që thojnë katër femra në atë kohë Isa kur u konë në fuqi përmenihërë që kanë gatu bukë, qaq i zoti që u konë. E jena hyp shkallëve të drunit, e dy dhoma jonë konë nalt në qato dy dhoma e kanë bo orarin. A din, edhe ni dhomë tjetër u konë e vogël në anë tjetër për arsimtar që rrishin qashtu.

Anita Susuri: A i ka pasë edhe ato drirtaret e vogla?

Isuf Peci: Po, po, po, krejt, krejt, krejt, qysh osht' sot. Me qat' meremetim, krejt i ka pasë qato frëngjit e krejt, po tash nashta veç që e kanë ly me, a din, e kanë renovu kështu pak, qashtu. E aty ku osht' sot vorri i Isa Boletinit me shokë të vet, ai guri osht' aty nashta muni me pa aty se ku... tri herë ja kanë rrëzu turqit, kurse lufta ma e madhe që u konë atëherë u bo me 1895-tën, kur u bo lufta ma e... në Sokolicë u bo, që shumë oficerë turq kanë metë të vdekur aty, që në atë kohë. Bile osht' shenja {kthehet majtas, tregon kah muri} me topa që e kanë gju prej kësaj ane, osht' guri shumë i madh, sa kjo dhomë osht' që ja ka hek gjysën, me 1895.

Korab Krasniqi: Deshta me pyt, tash aty osht' ni kullë, ku është...

Isuf Peci: Kulla e moçme, kullë që o qitash nuk ia ka mrri ymri, që thojnë pleqtë me hi, se s'e ka premtu koha Isën, a përpara qato që ja kanë rrëxu që osht' bara me... aty osht', ato po e dimë na, u konë e Isa Boletinit, u hi në to, e ka trashëgu, ka nejt. A qito thojnë maru e ka, po nuk u hi në to se s'e ka...

Korab Krasniqi: Ti në qeto e ke kry shkollën?

Isuf Peci: Po në qeto, ekzistuse që osht' qetash, po.

Anita Susuri: Tregut për shkollën fillore qysh e keni... edhe afër po më duket që e keni pasë... atë kullën e keni pasë afër, a po? S'ju ka ra shumë me ecë?

Isuf Peci: Paj valla në komë jena shkue.

Anita Susuri: Po.

Isuf Peci: Në komë jena shkue, thmi të vogël, qekaq {tregon me dorë madhësinë}, me konë smet² i madh veç me na çu dikush se.... Kqyre une po foli tash, se përpara kanë marrë dimnat ma të ronë, shumë mraza kanë marrë, *meçava* [srb.: furtunë] kanë marrë, po sot nuk po marrin ato. Une për shembull, une jom i hjekun, une për shembull as s'e di ktynehere mbrojtja ma e madhe e fëmive që na ka mbrojt u konë krejt çka kanë marue nonat tona, çerapë të leshta se ato osht' kundër mrazit, e kundër asi edhe xhampera na kanë maru primitiv {prek këmishën e vet}, xhampera me lesh të dhenve tyneherit, do hrka na i blejshin atëherë, e me opangë të Pirotit qysh janë konë ktyneherë në atë kohë a din, jo si tash që jonë këto "Pllanikat" po kushtojnë a din qishtu me opanga, a din e kena kry qeshtu. Me qira, me... une e kom përjetu edhe e kom nxonë kohën me gaz, gaz për shembull, me llampë, me llama, tregova edhe pak ma përpara a din, s'kena pasë rrymë na.

Korab Krasniqi: E prej landëve kështu në shkollë kur ke shku, cila të është dok që ka shku ma shumë?

² Nga gjuha serbe: Kur bie shumë borë.

Isuf Peci: Landtë a?

Korab Krasniqi: Po prej landëve, landëve mësimore, prej klasave, cila, cila të ka pëlqy ma shumë?

Isuf Peci: Valla historia. Po të kallxoj drejt historinë, matematikë s'kom ditë.

Anita Susuri: E qetash për histori deshta masi e përmendët, me ju pyt diçka, në komunizëm u konë e ndalume me ditë historinë e shqiptarëve për shembull, prejardhjen tonë e këto. E qysh e keni mësu ju historinë, a keni mësu veç për Jugosllavinë, a keni mësu edhe për historinë e shqiptarëve qysh...

Isuf Peci: Po na ma së shumti ju kena dhonë randësi që kena mësu në shkollë, Ndre Mjeda, Naim Frashëri, për qeto a din. Po u konë, në kohën time u konë landa sërbsisht, na e kanë imponu me dhunë që mos me ditë sërbshten ta ka hup edhe vitin. Po nuk e kena deshtë, me zemër nuk e kena deshtë. Po u dufke për atë shkak edhe kena ditë, po po thom mendim i jemi, nashta gaboj se atëherë u konë edhe obligim edhe ushtrinë me kry, na e kena kry tonë ushtrinë në ish-Jugosllavi. Po thom, nashta u konë mirë që na kanë mësu, tani kena mujt me marrë vesh najsen të padrejtë kur jena shku atje në ushtri e dikun qashtu. Bile sot diçka e pata në gjykatë ni rast, diçka për çikë, nashta s'o tepër me thonë. Se çika në pjesën veriore me nxjerr ni që nuk o nën hetime, kjo i folke shqip, me fakultet vajza jem, ajo sërbsisht, deri u avyta unë thashë, "Qishtu bab po thotë" a din, po du me ta lidh nashta jashtë teme. U konë sistemi...

Anita Susuri: Domethonë, ju ka hi në pune që...

Isuf Peci: Po, t'u ka imponue që nuk munesh me përparue, s'ke mujt as fëminë me e shkollue, as s'ke mujt ven t'punës me marrë, shancë teorike s'ke pasë me marrë.

Anita Susuri: Qato po thom se historia e shqiptarëve me mësu u konë e ndalume.

Isuf Peci: Po, po, rreptësisht u konë, bile me përmend Shipninë e këto, haj Zoti na rujt! Shkojshe në burg meniherë, qysh jo. Edhe u konë, po thom u konë qai sistem i instalum. Inteligjencën e kanë pasë shumë të zhvillume, a po kupton? Kanë punu natë e ditë për qat' sistem, për qat' shtet.

Korab Krasniqi: E ushtrinë meqë e përmende, ku e ke kry?

Isuf Peci: Tre muj e gjys e kom kry në '71-tën jom kon në Sombor, tani që prej Sombori më kanë pru në Batajnicë në aerodrom të aeroplanave.

Anita Susuri: Sa vjeçar jeni konë?

Isuf Peci: Atëherë kur e kom kry a?

Anita Susuri: 18-19?

Isuf Peci: Qashtu, kur e kom kry valla po qashtu jom konë, si e kom kry shkollën e mesme meniherë jom shku atje.

Anita Susuri: Nëse ki diçka hala për familjen s'po di? [I drejtohet Korab Krasniqit] Për familjen ndoshta kish qenë mirë me tregu diçka, për shembull për vllaznit, motrat sa keni qenë? Nonën qysh e kujton, me çka u marrë ajo?

Isuf Peci: Po nona, nona ma së shumti u marrë me pune të shpisë ktyneherë, ka qenë koha që e kena punu tokën, e kena mjellë grunë, misër, tërshon, bashqe, me qeto jena merr, me livadhe, me... ma së shumti me blegtori jena merr, me shtazë e, a din.

Anita Susuri: A keni pasë shumë, që po thuni serbët, serbët, komunizmi domethonë në atë kohë, që i ka marrë si...

Isuf Peci: Po, e ka marrë si haraç, ajo u konë...

Anita Susuri: Si haraç...

Isuf Peci: Po, haraç muna m'i thonë, tash haraç p'i thom, përpara i kanë thonë *utrina*, nashta nuk osht' qashtu na kanë imponu. E për shembull, ta ka marrë, çdo muj ta ka marrë ato, u ardh çdo vit ke pagu që i ke kullot lopët në tokë të shtetit. Kjo ka qenë, edhe në qoftë se nuk i'a ke pagu ti u ardh ta ka marr lopën ose shtazën ose ma të mirën s'të ka vetë hiç. Kjo ka qenë.

Anita Susuri: E për atë kohën që kanë mledh armë, a ju kujtohet juve?

Isuf Peci: Jo për atë kohë, jo nuk jom konë për atë kohë. Veç më kujtohet që bash qat' kohë që e ceka pak ma pare, Isai që e ka bo qat' çarmatosjen e Zubin Potokut që i ka mledhë, krejt Zubin Potokun e ka mbledhë Pajaziti, Isa. Krejt i kanë dorëzu armët që kanë deshtë me, e ajo ka qenë pleqtë kallxojnë për këtë vorrin e rusëve që u konë në Bajr të Kangjallozit³ i kanë thonë, për qata. Edhe sa u konë Isa që e murën e qunë e mashtrun, po ajo ish konë marrëveshje e Rusisë, Sërbisë edhe Turqisë, që me çu Isën, me largu për me vendos vorrin e Kangjallozit në Bajr këtu në Mitrovicë.

Korab Krasniqi: Baba yt a ka jetu në kohë të Isës, a qysh?

Isuf Peci: Jo, ma i ri u konë.

³ Nga gjuha turke: Kangjalloz - konsull.

Anita Susuri: Ma i ri.

Isuf Peci: Ma i ri u konë, po, po.

Anita Susuri: Tashti deshta me dalë te shkolla e mesme kur e keni vazhdu, a e keni vazhdu në Mitrovicë, a qysh?

Isuf Peci: Shkollën e mesme, po, po, në Mitrovicë. Ni kohë jom konë në Zveçan, tani jom konë në Bajr, e kom kry për elektrikist për tri vjet. I rregullt kështu jom konë. Tri ditë kështu jom shkue në praktikë, ndërmarrjen e kom bo në elektrolizë të cinkut, kurse tri ditë jom konë kështu në shkollë, kom mësue normalisht si shkollë.

Anita Susuri: Tash shumica që kanë jetu në Mitrovicë e në rrethin e Mitrovicës kanë qenë njerëz që zakonisht kanë shku në shkolla të mesme që kanë qenë në lidhje me industri, me xehëtari...

Isuf Peci: Po, po, veç për qata se Mitrovica ka qenë shtet, po mendoj qytet industrial, ma i zhvillum.

Anita Susuri: E ju për shembull babën nuk e keni pasë në Trepçe, se ka shumë që e kanë pasë, po ju prapë keni marrë vendim me shku qasi drejtimi.

Isuf Peci: Po u dufke ni zanat, unë për qata shkova për elektrikist të repartit edhe e kryva. Tajshi u punësova ‘88-tën, jo...

Anita Susuri: ‘81-tën.

Isuf Peci: Jo, ‘80 e... ‘78-tën.

Anita Susuri: Aha.

Isuf Peci: Jom punësu në Leposaviq, *elektriçar* [srb.: elektrikist] në minierën e sodit në Cërnac. Taj ‘81-tën um ka nxonë bash kur kanë qenë demonstratat atje, tanaj u shpërngula erdha në minierë të “Trepçës”.

Anita Susuri: Para se me vazhdu anej deshta pak për shkollën e mesme, cilat vite po i bjen që keni qenë në shkollë të mesme ju, ‘70-tave?

Isuf Peci: Po, qashtu, qaty po i bjen.

Anita Susuri: Atëherë, domethonë ‘74-tën u...

Isuf Peci: Kushtetuta u bo.

Anita Susuri: Kushtetuta u bo, edhe u konë një, qysh me thonë, një kohë ma e mirë për shiptarët, se i fitun do të drejta...

Isuf Peci: Kqyre kushtetuta, kushtetuta e '74-tës edhe Kosova në atë kohë kanë qenë element konstruktiv i ish Federatës të Jugosllavisë, ka pasë të drejta si gjithë republikat, gjashtë republika. Meqenëse, në atë kohë ka qenë edhe përfaqësuesi i Kosovës shqiptarë mos gabofsha ka qenë në kohë Fadil Hoxha e maj në men edhe ka qenë Sinan Hasani, anëtar i kryesisë të Jugosllavisë. Edhe kanë pasë të drejtë, po ajo kushtetutë, mendim i jemi osht', veç emrin nuk e kish pa pasë republikë, se i ka pasë të drejtat si të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë në atë kohë. Qashtu u konë, po.

Anita Susuri: E a ju kujtohen demonstratat e '68-tës?

Isuf Peci: Pak më kujtohen, pak më kujtohen. Se fëmi jom konë '56-tën, jom kon 10-12 vjet, studentat që jonë çu, po. '81-tën, po...

Anita Susuri: '74-tën qysh e keni vrejt ju, a keni vrejt naj ndryshim që ka, që o ma e mirë situata, ju vet?

Isuf Peci: '74-tës?

Anita Susuri: Po.

Isuf Peci: Po ka qenë, ka qenë në lehtësim shumë i madh me fol realitetin, qaty pak na u kanë hapë dyrtë e Kosovës {hap duart}, pak me pa dritën, dillin me pa pak, se jena konë shumë, shumë të asi... Qaty e kena pa, i kena pasë do të drejta, po e drejta që m'u konë në vena kyçe nuk kena pasë. Në atë kohë kanë pasë veç njerz të që janë konë, ai sistem u konë që e ka ditë baba, babgjyshi e katragjyshi, a jonë bash për qat' sistem gjinë. Se bash gjithkush nuk ka mujt me depërtu në venda kyçe, ajo ka qenë e sigurt. Për shembull, ata të policisë, të hetuesisë e në komitete qysh u konë ai sistem, nuk ka pasë gjithkon. Për shembull, e ka lyp baba, babgjyshi e katragjyshi a u konë kaçak, a u konë kundra këtij sistemi, a u konë, si je konë shans s'ke pasë këtu me depërtu hiç.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt pak ma shumë për qet' periudhën e shkollës, pak edhe për aktivitetin, qysh me thonë, për shoqinë po edhe për aktivitetin jashtë shkollës, a keni shku për shembull, a jeni marrë me aktivitet kulturor, a keni lexu në kohë të lirë, a keni dalë dikun a? Qysh ka shku kjo sa jeni konë i ri? A keni jetu në Mitrovicë a?

Isuf Peci: Jo, kena jetu, në fshat kena asi na edhe po të thom une, jena marrë na me, me... në atë kohë. Po prej që u dal, u formu Lidhja Demokratike në atë kohë, mo prej atëherit qaty jom konë në

kryesi tri fshatrave jom merr. Më kujtohet ai rast që na i uzurpun me media me krejt që jonë konë pesë minuta edhe pesë minuta në 11, Zagrebi na ka pat mundësue kurrë s'e harroj. Cili vit u konë nuk e di, veç jom konë i obligum në tri fshatra me shku me kallxu qato edhe pesë në 11:00 e kena pasë caktume të natës me shku me na kallxue, se na e mbyllën neve atëherë Kosovën, na e mbyllën hermetikisht që nuk guxojshin me dalë, i mbyllën mediat këtu. E shkojshum i kemi pasë burimet e sigurta këtu, shkojshim na kallxojshtum çka o vendos, çka po do me ardhë, qeto.

Anita Susuri: Ajo u konë ma vonë po më doket në vitet '90-ta.

Isuf Peci: Kur i mbyllën këto, qatherë.

Anita Susuri: E deshta m'u kthy te shkolla mesme, se po më intereson qekjo. Ju keni jetu në fshat e keni udhëtu në Mitrovicë...

Isuf Peci: Në komë, në komë kena udhëtu.

Anita Susuri: Qysh u konë qekjo?

Isuf Peci: U konë fshtirë, u konë fshtirë. Ni rast um kujtohet, e çoi Zoti edhe pak pare, e ceka që ktynehere kanë marrë edhe dimrat e ronë, kanë marrë mraze të ronë, që kur jom dalë prej në dalje të Mitrovicës ku o sot që u konë ushtria e Sërbisë, e Jugosllavisë deri atje nalt te kodra përpetetë {ngreh dorën}, anena jena shku dej në gjystë edhe ka dashtë me na mytë mrazi, qishtu na sillke {lëviz duart në rreth} edhe jena kthye në Mitrovicë. Edhe kur jena kthye në Mitrovicë me dy kusheri të mi, u dalë... kajshim na, të vogël jena konë qekaq {tregon madhësinë me dorë}. "Çka keni bre?" Na ka marrë, e na ka çu mrena, na ka shti, na ka nxe. E tajshi ma fort ishin bo marak familja, mos na ka myt mrazi, familja jonë nuk e kanë ditë, a di. Kena hjek shumë, kena hjek shi, e borë e, mraz e, prej qenve jena tut e... Vallahin, ishalla more Zot qekjo rini mo nuk e pret atë kohë, u konë fshtirë, fshtirë u konë shumë.

Anita Susuri: E qysh u bo që ju, thatë që masi e keni kry shkollën e mesme jeni shku menieherë në ushtri...

Isuf Peci: Meniherë në ushtri, po.

Anita Susuri: E qysh u konë atëherë, po më doket janë konë do përcjellje me shku në ushtri e?

Isuf Peci: Po, po, po edhe atje, edhe atje në ushtri, po qysh i kanë shku shënimet prej këtuhit atje i kanë shku drejt për drejt për Mbrojtjen Popullore, atëherë u thirr Mbrotja Popullore. I ka çu shënimet tua atje çfarë njeri je, cilës familje je. Po, po edhe atje je përcjellë. Po, je përcjellë, e ke pasë nifarë, edhe ushtarë jena konë ma shumë se, atëherë i kanë thonë desetar, shqip tash nuk e di çfarë *çini* [srb.: gradë] osht...

Korab Krasniqi: Tatar.

Isuf Peci: Nuk e di, tatar a qysh i bjen, nuk e di ça i bjen. Atëherë nuk ke mujt, shansë edhe teori, edhe fakulltetin me pasë... edhe naj shofer, veç me pasë shumë të ngjofshëm, që i ka shku prej këtuhi çfarë njeri osht', ta ka dhonë shofer. Po edhe shofer me ta dhonë atje, nuk ke pasë shansa autobusat me duhëheqësa ushtarak me i vozit, as naj ushtarak të lartë nuk ke pasë shansë, veç ta ka dhonë naj kamion transportues, me çu bukën a dikun. A kështu ushtar i thjeshtë, kena rue, na kanë ru edhe kur jena dalë në rojë. Disa herë kanë ardhë natën me provu a jom flejtun, a s'jom flejtun, në Sombor atje, natën më kanë ardhë, po.

Korab Krasniqi: Në çfarë njësie jeni konë?

Isuf Peci: Unë jom konë në veza, lidhëza, lidhje.

Korab Krasniqi: Lidhje a.

Isuf Peci: Në lidhje jom konë, po.

Korab Krasniqi: Se babën e kom pasë, ai ka qenë tankist.

Isuf Peci: Tankist, po.

Korab Krasniqi: Edhe krejt i kanë pasë ato tatuazhet.

Isuf Peci: Po, po, po {prek krahun}.

Korab Krasniqi: A e ke bo ti najnjo?

Isuf Peci: Po, e kom bo, qetu e kom {fillon ta ngreh mëngën e këmishës} edhe me mujt me hjek pare dho. Veç e kom shkru qetu qe {tregon tatuazhin në krah}.

Anita Susuri: (qesh) Po.

Isuf Peci: Qitu "JNA". Edhe shumë po më thojnë, "Pse bre, Pec?" a din. Kqyre nuk po shoh {lexon tatuazhn} "16.8" a sa osht' nuk e di, s'pe shoh këtu. Edhe shumë më kanë dhonë kritika, bile ni ditë edhe hoxha më tha, tha, "Hiçe, Pec" tha. Thashë, "Kjo bre nuk u konë e Sërbisë", kjo kur e kom bo unë u konë në nivel të Jugosllavisë. A din, nuk e kena ditë. A me mujt me hjek... nuk o mirë, po më ka metë tash, s'kom ça boj.

Korab Krasniqi: E ushtarët tjerë, në ushtri Jugosllave ka pasë shiptarë, sërbë...

Isuf Peci: Po, po, malazezë ka pasë, po në atë kohë...

Korab Krasniqi: Qysh i keni pasë raportet?

Isuf Peci: Raportet, vallahi jena rrehë, vallahi jena rrehë, jena rrehë. Bile, ni rast une më ka pa çu gati, se e lëshova atë vendin e punës aty, e lash. I kena pa ru në Batajnicë, në Batajnicë aty u konë nifarë rasti që i kena ru ato antenat kryesore teleprinter i thojshin, atëhere ishin asi, e çilshe nifarë dere kështu e hishe atje në dhe krejt zyre jonë konë. Aty e përcillke krejt gjendjen në Kosovë, në Kosovë e në ish-Jugosllavi, e unë e lëshova rojen, e lëshova rojen. Janë ardhë aty kurrfarë rojtari {mbulon kokën me dorë}, gati më ka pat çu në *Vojni sud* [srb.: Gjykatë ushtarake], atëherë në ushtri, gjyq ushtarak, a qysh p'i thojnë atëhere, e u konë... A ma afër neve jonë konë sllovenët edhe kroatët, a ma të kqi jonë dalë maqedonët, gati si sërbët, njejtë jonë konë. A mas çetnika që jonë konë këtu, jonë konë sërbët e Bosnjës, a me ta nuk kena mujt. S'e kena çu mirë me kërkon, veç ata jonë konë kështu s'kanë dashtë me na pa me sy kështu hiç.

[Këtu ndërpritet intervista]

Isuf Peci: Ata jonë konë... a sllovenët na kanë mbrojt gjithë, edhe sllovenët edhe kroatët i kena pasë dorë të djathtë, kur ish diçka e padrejtë kundërshtojshin. Po atyne nuk guxoishin ata me ju dhonë vërejtje.

Anita Susuri: Që po thoni që jeni rrehë, a ju kanë dënu diçka?

Isuf Peci: Më kanë dënu, dënimi u konë ma së shumti të çojke në rojë edhe të lejke për m'i fshi këpucat e korridorin, dënim, edhe nevojtoret të lejke me i fshi. Qato, qai dënim u konë, ma shumë se qat' dënim me marrë gjyq ushtarak gati, qaty rrezik. Gati e kom pasë hongër niherë, po më pshtoi Zoti zahere {rrudh supet}.

Anita Susuri: Sa keni nejt, ni vit a sa? Në ushtri.

Isuf Peci: Ni vit une kom nejt më doket, se u konë 18 muj, 15 muj, mu më ka ra ni vit.

Anita Susuri: A keni pasë komunikim me familjen?

Isuf Peci: Po, po.

Anita Susuri: A keni shku në shpi, a qysh ka qenë?

Isuf Peci: Po, po, u konë ajo komunikim, të lëshojshin me ardhë, ni herë të lëshojshin. Po, m'u konë i digjushëm për ta, m'u konë i nershëm, dikon e lojshin edhe dy-tri herë. Në bazë të njerëzve, qysh jonë gjindë.

Korab Krasniqi: Ushqimin qysh e keni pasë?

Isuf Peci: Ushqimin, ushqimin si për tonë njejt u konë, ushqimi u konë njejtë. Ka pasë disiplinë, në qat' sistem u konë, s'ke guxu kurgjo pa drejt, t'u ka duft gjithmonë m'u konë i pregaditë. A pak u konë pak zullum te na kur rahshum me fjetë u duft krevetin kur je çu me lonë aty që je shku në ushtrime, u duft si qekjo vijë {prek tavolinën} çarshafi me konë në tona anët, qaq preçiz e ka lyp. Pak që e ka pa veç që u asi... ta kapke kështu {sikur hedhë diçka lartë} thojke, "Përsërit!" Edhe këpucët u dufke me i fshi se të çojke prej gjumi thojke, "Çu fshiji këpucët!" Edhe dënim ta dhake nevojtoret krejt me i fshi.

Korab Krasniqi: Çfarë tabiate të mira ose të këqija të kanë metë prej ushtrisë? Për shembull, baba jem e ka pasë tabiat hajke shpejt shumë bukën. Na i thojshim, "Ha ma kadale bre". Çka të ka metë ty?

Isuf Peci: Po, shumë e vërtetë. Na ka metë që bukën e kem hongër shumë çpejt edhe llaf nuk kena bo fort, a din kur kena hongër bukë, se aty me metë ma i mrami me të denue. Qajo na ka metë shprehi neve ma së shumti.

Korab Krasniqi: Disiplinë?

Isuf Peci: Po disciplina u konë në nivel, të kallxova unë, pak s'ke guxu me fol. Bile kur na kanë bo rresht kështu s'ke guxoft me fol hiç, se të denojke, po.

Anita Susuri: A mendon që kish qenë mirë për gjeneratat e reja me ndodh qekjo, me shku në ushtri prapë?

Isuf Peci: Po, mendimi i jemi osht' jo qashtu në përcjellje qysh jena konë na. A ushtria, ish duft me shku gjeneratat e reja. Se kqyre pa e kry ushtrinë, se ushtria njo, burgu dy edhe fakullteti tre, janë fakulltete. Une këto i kom përjetue vet, se në ushtri sheh gjithçka, në burg, burg jom konë, sheh gjithçka, po nashta fakulltetin ju e keni, unë s'e kom fakulltetin, po edhe në fakulltet mëson gjithçka. Në ushtri mëson qysh osht' inati, e qysh osht' pastërtia, qysh o disciplina, në burg edhe ato i mëson, në burg jom konë, në çeli edhe fakulltet tash i mëson edhe ato i dinë, dinë. Për shembull, me këto tria kur i kie e din çka o mirë, çka o keq, çka o gjyna, çka o marre, krejt i dinë këto. Mendimi jem o nashta gabo.

Anita Susuri: Zakonisht kur janë kthy prej ushtrisë i kanë martu djemtë, a ka ndodh edhe me juve qashtu?

Isuf Peci: Qysh? {afrohet për të dëgjuar më mirë}

Anita Susuri: Kur janë kthyer prej ushtrisë djemtë, i kanë martu, a ka ndodh edhe me juve?

Isuf Peci: Jo, jo, u shku në kohë e gjatë nuk më kanë martu meniherë, masanej më kanë martu. Po unë mendoj që atë gjest që e kanë bërë, mirë e kanë bërë. Se u mësua çka o mirë, edhe kur e ka mësua qat' disiplinë ajo edhe familjen e krijon të pastër në njëfarë mënyre, se ka marrë mësim atje, a po kupton, mendim i jemi osht'. Nuk kanë bërë keq.

Anita Susuri: E në "Trepçë" qysh u bërë që ja keni fillu me punë?

Isuf Peci: Po në "Trepçë" u bërë atje, hini ujë, u bënë demonstratat e '81-tin, ja nisën njëfarë presioni, hupë besimi i tyre...

Anita Susuri: Domethënë, '78-tën keni fillu.

Isuf Peci: '78-tën atje, dy vjet e diçka tash u bënë demonstratat mu nuk më mëtej mo atje më. Tash me të ndjerin ish-drejtor i "Trepçës", kushëri e kam, ka vdek vjet. Nazmi Peci, pashta keni ndëgjue, ai ka qenë drejtor i prodhimit, ai u konë edhe në izolim, u konë në burg në Leskovc, kur u bënë grevat këtu. Ai më mërt edhe më pruni në "Trepçë" këtu, erdhë në "Trepçë".

Anita Susuri: Çka keni... na tregoni çka keni fillu me punë në "Trepçë"?

Isuf Peci: Ma s'pari kom fillu, llatat ja u kom dhënë punëtorëve, kom punu aty, llatat që i kena mush me rrymë, ja u kom dhënë xehëtarëve për me shku që kanë çpu në minierë. A ma së keqti e kom pasë, edhe ma së brengje e kom pasë edhe ma së gjynahi më ka ardhë, e ma së keqti më ka ardhë kur ka pasë fatkeqësi. Unë i kom zatet s'di sa fatkeqësi që janë myt këtu në minierë edhe më ka ardhë që ja ka lëshu llatat në punishte. Me ta lëshu llatat në punishte osht' vdekje. Qat gjithmonë në minierë duhet me shku ka dy vetë. Edhe atëherë janë konë llatat me thartinë, kiselinë i kena thonë na në atë kohë. E me ja lëshu në punishte atje veç në mëshirën e Allahut me konë, me konë xehëtar i mirë në bazë të gypave munet me dalë dejt te pusorja.

Anita Susuri: E qysh ka ndodh s'e ka gjet rrugën, a qysh?

Isuf Peci: Paj jo, xehëtari i mirë edhe mbikëqyrësi në minierë e ka obligim me kqyr në fund të ndrrimit a i kanë ardh tonë xehëtarët, se vanohen. Edhe në bazë qat tash kur e kanë ditë që u vonu xehëtari, u shku në punishte e kanë gjetë atje. Po, mu asi pak para punishte, une e kom si prej përvoje këto se kom nejt shumë edhe me inzhinjera me asi, në bazë të gypave të ajrit del te pusorja. Se ata janë gjithë në anën e djathtë i kanë lonë, e në bazë tyre duhet me dalë, t'u prek, t'u prek del deri tek pusorja, qashtu.

Anita Susuri: E qysh munet me ndodh aksident? A shkel dikun keq, a të bjen diçka, a qysh?

Isuf Peci: Ma së roni... po munet me ndodh. Përpara, përpara ka qenë nrysh, përpara kanë qenë aq shumë minj, minj ka pasë gati edhe sa qajo çantë {tregon djathtas}. Minjtë e kanë ditë kur shemet edhe kur dridhet toka. Nja tre-katër minuta ose ma asi, jonë ikë edhe kanë bërtitë sa kanë mujt janë përplasë, që ikë prej qati vendit se meniehrë ka m'u shem. Edhe u konë e ndalume rreptësisht me ligj, u konë me i myt ata minj. E të shumtëve ja u kanë hongër edhe bukën (buzëqesh), *auu* {onomatope} ja u kanë hongër bukën qaq shumë minj ka pasë. Po qe mas lufte asnjë s'metë gjallë, puna e perenisë.

Anita Susuri: Domethonë minjtë i kanë përdorë si kallxus kur po bohet naj rrëshqitje.

Isuf Peci: Po, po, po, po. A edhe ni rast e kom kujtim prej miniere, kur u dridhë toka jom qëllu bash në punishte, prej ni horizonti {shpjegon me duar} kah shkoj teposhtë um ka ndodhë. Gjo ma fshtirë nuk kish në jetë tem edhe ato e kom ngjoftë. Qaq ushtimë i ka shkue hymjes *ouuu* {onomatope}, thashë që gjo e gjallë nuk e prit. Kur dola shkallët rrëshqitshin *avava* {onomatope}, veç bojke *auu uuu* {onomatope}, si valët e detit që bojnë natën, qashtu bojke. Kur dola thanë, “U dridh toka”, thashë, “Po”. Edhe ajo ish tmerrim i madh ish. Une ato e kom përjetu domethonë, e kom përjetu edhe raste kur jonë myt minatorët në xehe i kena nxjerr e qashtu.

Anita Susuri: E qysh u konë qajo, për shembull çdo ditë me hi në minierë edhe me prit që munet me ndodh diçka e keqe, a jeni frikësu?

Isuf Peci: Po, po u msojshe. Në fillim o pak fshtirë, po dikur msohesh, msohesh. Dikur të doket si jetë e përditshme aty. Fshtirë osht', me hi thojnë munesh me hi, po me dalë s'dihet a del, a s'del. Atje hin bon vaki t'u nxe dielli, del o t'u ra shi. Bora bjën, *meçava* [srb.: furtunë] dy metra se sheh prej bore venin. Po atje o nxet, ka vene shumë të nxeta, bile bash ni rast osht' atje në dhetin [horizont], mes dhetit edhe nimdhetit, osht' qitu del ujë {tregon me gisht} ftohtë, qitu ma nxet, qitu krejt valë, se kanë diferencë as ni metër e gjys, puna perenisë. Qitu krejt valë, {tregon me gisht} qitu ma asi, qitu ftohtë del.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Tjetër deshta me ju vet për '81-tën...

Isuf Peci: Demonstratat.

Anita Susuri: Kur kanë ndodhë demonstratat qysh u konë këtu situata në “Trepçë”?

Isuf Peci: U konë e acarume, i kena ditë të gjitha informacionet i ke pasë. Aty ka nis rrënimi i autonomisë të Kosovës, aty ka nis. Fillunë me i hekë njerëzit përgjegjës, njerëz të zotë shkurt. Po kur filloi ajo, me disa amandamente fillunë në Komitetin Krahinor, u qujt atëherë me e hjek e me e rrënu

atë kushtetutë të '74-tës. Aty ke mo vija e kuqe për neve edhe nuk patëm qare, nuk patëm qare e prunëm vendim që, që veç na minatorët munëm diçka, se greva e minatorëve edhe ndërkombëtarisht e ka peshën ma të madhe prej të gjitha ngjarjeve që i jep fryt qati shteti e qasaj popullate. Edhe u futëm në grevë, po na mashtrun.

Anita Susuri: Tash '81-tën...

Isuf Peci: Aty filloi rrënimi i Jugosllavisë, filloi rrënimi i Jugosllavisë...

Anita Susuri: Po, po, por fillun edhe ato parollat për "Trepçën", që "Trepça" punon...

Isuf Peci: Po, "Trepça punon, Beogradi ndërton", po, po ka qenë ajo.

Anita Susuri: E mu po më intereson ju si punëtor i "Trepçës" edhe tjerët kolegët e juaj, çfarë qëndrimi keni pasë, çka keni menu, qysh, qysh, qysh e keni menu ni zgjidhje prej qesaj?

Isuf Peci: Po na kena menue, edhe pamë që gjithë po shkon ma ronë, që nuk kena tjetër rrugëdalje, tek ma e mrama me dhonë edhe jetën për këtë Kosovë, se e pamë ja nisën shkollat e, si e thashë ma parë rondë e na përcjellshin. Edhe nuk ka pasë zyre, nuk ka pasë ven, për "Trepçe" po foli une, nuk ka pasë ven që nuk u konë ka ni sërëb në prezencë në zyre. Edhe kurrë nuk folshin veç inçizojshin, si qekjo {tregon mikrofonin} që po inçizon qishtu. Veç çkrujke çka po bohet, çka po folet, çka po asi, çka... edhe i dhojshin informacionet çka po ndodhë.

Anita Susuri: Ju na tregut që ka pasë edhe shumë informatorë, që kanë punu, që jonë konë të infiltrum.

Isuf Peci: *Auuu* {onomatope} ka pasë vallahi edhe shiptarë, vallahi po, ka pasë bashkëpunorë të tyne. Po, tash po munohen me u paraqit haxhi, s'jonë haxhi ata, se kanë bo sherr o vlla. Po të kallxoj, osht' e tepërt, ka pasë kogja shumë. Bile, bile une kur jom konë në centrall nalt, më çoi drejtori tha, "Mule, Pec" tha, se atëhere në atë kohë ka pasë veç qesi telefonash me tel {tregon majtas}, nuk ka pasë si tash që po folin qesi.

Anita Susuri: Mobil.

Isuf Peci: Mobil nuk ka pasë. E krejt sërëb çka kanë punu po foli për "Trepçe", në flotacion, krejt kur i ardhke *çeku* [srb.: faktura] ai për me pagu në "Trepçe" i ardhke Zoti e din sa, sa me pagu. Se ja dhojshin ka gjys ore, ni orë ja dhojshin me fol me Kragujevc, a.... Bile, ni rast më kujtohet erdh ai *çeku* në flotacion, thotë drejtori, Burhani thotë, "Shko Pec poshtë" thotë, u konë nifarë Maksimi çetnik u konë ai poshtë, edhe u konë ni Millka e vogël {tregon me dorë madhësinë} drejtoreshë e fllotacisë. Tha, "Shko poshtë!"

Kur po shkoj, po më thërret ni sërbi, se ka hek atë shubarën {përshkruan me dorë}, shubare na ju kena thonë këtyne të sërbeve që i kanë ato, që i kanë. “Ama” tha “qet numër në Krlevë”, thashë, “Ani, ama” ja shënova numrin edhe “Ku je?” Në filan vendi, ja dhashë atë numër edhe e thirra unë bash qat herë. Tha, kur e thirra thashë, “A o Krleva?” Tha, “Po”, 036 kurrë s’e harroj atë numër, 021 e ka pas Novi Pazari, 011 Beogradi, kurrë s’i harroj ato m’u kanë pikë {prek kokën}.

Po ma bon tha, kur thirra në Krlevë, “*Ovo je privatna kuća*” [srb.: Kjo është shtëpi private], shpi private. Ni herë a dy, tri e katra, a ky më rrejti ky sërbi këtu tha, “Osht’ firmë për me ble diçka për fllotaci”. U munu me më tradhtu mue. Edhe thirri, thirri edhe nihere mas atij thirra, tha, “*Privatna kuća*. Mos thirr mo” a kur thirri ky që ma dha qat’ numër ky sërbi që ish në pune thashë, “Qysh po rren bre burrë,” thashë, “ajo osht’ shpi private, ti po thu për fllotaci”.

E mas ni kohe nuk kanë shku as dhetë minuta kur erdh edhe drejtoresha, shumë çetnike u konë Millka, Millka Cikiq u thirrë, ajo ma çetnike, e vogël qe {tregon me dorë madhësinë}. I ka ra derës, po unë kisha forcë në atë kohë, se u konë Burhan Kavaja e kisha drejtor, ai më çoi naltë. I ka ra derës aty në centrallë edhe hini tha, “A je normal ti? Kush të ka çu ty?” Thash, “Merru vesh me Burhan Kavajën nalt,” thashë, “ai më ka çu këtu” edhe dul përjashtë. E po du me cekë jena konë bre të shtyptë, të përcjelltë jena konë, shumë kena hjek gjenerata jonë. E ishalla more Zot, ju të ritë e trashëgoni e e mani këtë shtet e vetëdijësohem pak. Qishtu u konë.

Anita Susuri: E s’po di a kish qenë mirë me vazhdu për marshin me fol, kur kanë fillu marshet. Paraprakisht qysh, qysh u kuptu që po doni me bo diçka për me shpreh pakënaqësinë?

Isuf Peci: Shiqoni këtynehere datat nashta i harroj pak, po atëhere kur u bo ni tubim, ma shuëm ke pasë inteligjencë, njerëz që të kanë përcjell, qaq frikë na kena pasë nërmjet veti që ti nuk i ke besu shokut tond. Na ka fut në palcë atë ide, në atë sistem nuk ke guxu me shpreh atë mendimin. Po me qeta jena {prek buzët} marrë vesh, me buzë, si jena hi në tubim në sallë naltë, sot është ajo sallë, me qeta. Edhe aty jonë konë të caktum gjintë kush me fol, nuk ka mujt kush don me fol. E pamë që s’kem tjetër rrugëdalje tani fillum për marsh, për Prishtinë, shkum në Prishtinë qysh kallxova edhe në fillim atëherë.

Korab Krasniqi: A din me spjegu kështu ma detajshëm qysh u konë qajo ditë, qysh ja ka nis qajo ditë për ty?

Isuf Peci: Ndërrimi i parë u hi edhe ka vendos poshtë mos me dal, ju ka bashkangjit i dyti, i treti edhe ren tanishi, na tu u munue, tu hi poshtë edhe jena...

Anita Susuri: Jo, jo greva, marshi. Kur ka fillu marshi për Prishtinë, për Mitrovicë.

Isuf Peci: Datat nuk i di se i kom harru, se i kom harru... 30 e kusur vjet.

Korab Krasniqi: S'ka problem veç qysh të kujtohet ty.

Isuf Peci: Dulëm, a di qysh...

Korab Krasniqi: Qysh ja ka nis qajo ditë për ty, çka keni bisedu?

Isuf Peci: Ajo ka qenë, qaq të vendosun jena konë, sikur bletë, a din çka jonë bletë, që në sekond mledhën, qashtu të organizum jem konë, spontanisht jena mledhë edhe jena nis edhe në stadion. Kur jena shku te ura e Sitnicës më kujtohet ni rast, nuk e ngjo ato, ai u konë shqipëtar më zemër, ma ka dhonë ni letër, tha, "Me lexue" se kena pasë me hi na në stadion "Adem Jashari" {tregon me gisht djathtas}, në Mitrovicë.

Po, ma mirë që nuk hinum se e kishin pasë njet me na bo... kështu që, njo të gjallë mos me lëshue. Edhe atë letër tana masanena më ka thonë ai, "Mos e lexo se s'po himë hiç". Edhe kur jena avyt [afruar] janë mundu ata me çdo tendencë me na fut në stadion, e nuk kanë mujt. E aty masanena ka fillu helikopteri, na kanë çpartallu, dikush në ujë ka ra në Ibër, se Ibri o ngat aty, dikush anena për shpia tu na marrë, tu na asi, qashtu ka qenë.

Kurse në Prishtinë kur jena shkue, kurrë s'e harroj, datat nuk po muj me i ditë, atë ditë ka pasë me ardhë Robert Doli, na jena konë me shlema, me shlema, me helmata e kena prit. Kur ka kapërcy helikopteri, u ardhë prej poshtë, u ardhë Rexhep Qosja, kurrë s'e harroj {bën sikur mban çantë dore} me ni çantë u ardhë aty edhe ai ka marrë pjesë në qat' mledhje. Kena rreh shuplakë {bën sikur aplaudon} edhe në ata si ka kapërcy Robert Doli, që u konë, se kurrë Zoti mos e hupt Amerikën na ka nimue gjithë edhe ja ka nis njësia speciale, jena bo pikë e pesë, jena ikë atje për Prishtinë nuk i di ato lagje, na gjujshin kësi gaz lotsjellës, na dhonshin kepë.

E ju ka ardhë gjyna, kanë kajt, veç na kapshin qitu më kapshin zhag {tregon prapa qafës} e më shtishin në derë, e mshelshin derën për me na shpëtue. "O hiçni shlemat", thojshin, po na e kem qat' traditë shiptarët që, si me thonë diqysh, njo për të gjithë, a din jena konë qashtu, s'i hiçshum. "Hiçe" thojkë, "shlemin se nuk o puna shlemit, se marut". E na kanë asi, na kanë shpartallue atje, kurrë s'e harroj ato. Nuk e di atë datë, kom qef me ditë atë datë, kur jena konë në Prishtinë kur ka ardh Robert Doli. Kurrë s'e harroj ato, po edhe këtë marshin, kjo Kaqusha Jashari që na ka ardhë në sallë.

Anita Susuri: E tash kur jeni mledhë me shku qaty për Prishtinë, jeni bo bashkë...

Isuf Peci: Po.

Anita Susuri: Edhe keni marrë vendim në kamë me ecë, a ta ka marrë menja që ke me mujt me mrri?

Isuf Peci: Jena konë të vendostë ja gjallë, ja vdektë me shkue. Po të kallxojë drejtë dy herë kanë tentue, i kena pasë rojet tona, janë konë në rendin e parë me pllakarta. Jom konë aty në rendin e parë, une s'e harroj ato kurrë. Në Shipkofc kanë tentu me na kthye, s'kanë mujt me na kthye. Kur jena shku në Milloshevë pak pa dalë qaty, kurrë nuk e harroj, tash janë maru ndërtesa aty, jonë konë arat i kanë pa livru, nuk e di çfarë kohe u konë, mdoket në vjeshtë u konë qat'herë, qaty na kanë dalë, u ardhë Remzi Kolgeci me qat' fare pallte, kurrë s'e harroj palltë e bardhë u konë e gatë. "Për riza të Zotit" tha, "kthenu bre se na morët në qafë edhe neve". "O pasha Zotin" tham, "ja gjallë, ja deké", në dy anët, veç kena bërtitë, "Auu {onomatope} përpara shokë!" E arave jena hi (përlotet). E shkum tani anej në sallë qashtu.

Anita Susuri: E a ju kujtohet çka keni fol rrugës, çka keni mendu që po ju pret?

Isuf Peci: Nuk kena fol shumë, jo pasha Zotin. Do na u smujshin, qysh jena qëllu me qato tesha tash osht' keq me fol. Po me qato tesha, helmata, ju ardhke era minierës, qato që kena punu në punishte, dikush me shlema e me qato jena shku, qashtu jena hi, të zhyta qato tesha. Me fol s'kena fol, njo me shoqin nuk folke, hiç, thu ti se jena kon krejt në bele, po ma zi se beleja u konë ajo. Qashtu, po gjithë atë munim për qeta e dhamë edhe na kanë lonë. Une po foli për veti, 42 vjet qitu jom shkue me 90 euro në penzi {ngrit duart}, qe.

Anita Susuri: Shumë keq.

Korab Krasniqi: Qai konfrontimi me polici, se policia ka pas tentu me ju nal juve...

Isuf Peci: Po.

Anita Susuri: Kordon jonë bo, a po?

Isuf Peci: Po, kordon.

Korab Krasniqi: Qysh ke reagu në qat' moment?

Isuf Peci: Tu shty, na dul.... Po menon në Milloshevë aty {tregon me gisht përpara}?

Korab Krasniqi: Po, po.

Isuf Peci: Po aty. Edhe harrova me thonë, edhe në rrafsh aty në Prishtinë, vendin nuk e di po në rrafsh po, edhe aty na kanë dalë, po edhe aty e kena shpartallue. Dikush ju tha, tha, "Mosni se kanë vendosë" tha "këta" tha, "veç i çojmë poshtë se këta pa shku në sallë s'kanë m'i lonë". E qaty tu shty e tu shty se nuk na lojshin, kur hinëm na arave lloq e asi atëherë s'ja u murr menja arave e pamë tani shumica dul

përtej tyne atje i nxoni, i shtinë midis ata milictë edhe tanaj thanë, “Leni”. Po, po thom, po thom edhe jom i bindun, ma mirë që ka pasë në qat’ kohë policë tonë shqiptarë se shumë keq kishum kalue, po ta thom me plot sinqeritet këto se i dhimke zemra. Deshti s’deshti i ka dhimtë edhe atij zemra pak.

Korab Krasniqi: E kur hinët në sallë?

Isuf Peci: Hinëm aty, pritëm aty, erdh Kaqusha Jashari na majti fjalim. Tha, “Kadale dihet zgjidhja” na veç qashtu e qashtu. Dulëm prej atuhit, tanishi...

Korab Krasniqi: A të kujtohet çka jonë konë kërkesat e juja për në qat’ marsh? Për çka e keni bo marshin?

Isuf Peci: Po për qat’ marshin mos gabofsha u konë për mos me na hekë, krej qëllimi... kur u avytëm afër fakullteti, e kur u avytën kuadrat mo s’patëm ku me shku na, kuadrat mos na i ngucni, fakulltetin tona, tona, edhe që bonën diferencim në punë e, drejtorat e inzhinjerat e, mjeshtrit, edhe mjeshtrit që jonë konë ne vena kyç i kanë pa largue. Qaty tham për fakulltetin, tona i tolerojmë, qeto nuk e tolerojmë, shkollat njo edhe fakultetet mos me na i nguc, qaty qato janë konë krejt qai qëllimi tyne. Kur na i prekën qaty mo, nuk patëm ku me shku mo, i erdh funi.

Korab Krasniqi: Përveç Kaqusha Jasharit, kon tjetër e keni taku në sallë? A të kujtohet?

Isuf Peci: Vallahi jo, pos Kaqushën, Kaqusha më kujtohet a tjerët... ka pasë edhe tjerë të Komitetit, po nashta s’i kom njoft. Po edhe këta që jonë ardhë aty, edhe që na dalshim pa konë prezent edhe naj sërb me ta nuk ka bo vaki. Po ata s’kanë fol kurrë, nifarë mënyre veç e kanë vëzhgu terenin e kanë punu për interes të tjetërkujt.

Korab Krasniqi: Po kur jeni kthy, prej informatave edhe prej leximeve...

Isuf Peci: Qysh kena mujt jena kthye.

Korab Krasniqi: Qysh keni mujt, me autobusa, me...

Isuf Peci: Dikush në komë e me naj kerr e, për faqe të zezë.

Korab Krasniqi: Kur ke mrri në shpi’ qysh je ni qat’ ditë?

Isuf Peci: Kurgjo, me të thonë të vërtetën, për veten po foli, i ardhke era, i ardhke era shkret natyrës, era nuk i ardhke gjallni diqysh i ardhke shumë keq i ardhke a din. U dike që nuk o në rregull diçka edhe në hava {hap duart dhe shikon lartë} edhe në dushk {shikon përreth} e në mal, e në rrugë e, u dike që nuk osht’ mirë gjendja, shumë keq osht’.

Anita Susuri: A keni prit tash që ka me ndodh arrestime, ka me ndodh... në pyetje me ju marrë?

Isuf Peci: Po tanajshi fillon arrestimet, fillun ndjekjet politike, fillun arrestimet. Neve na arrestun, dikujt ja dhajshin 30, dikujt 20 ditë, dikujt qishtu, krejt jena konë gati 80 për qind, 90 për qind krejt gati jena konë...

Anita Susuri: Qysh u konë tani atmosfera në punë mas marshit?

Isuf Peci: E zyrtar u konë, e zyrtar u konë, nuk ke pasë vullnet me punu hiç mo. Se për shembull, kur ke punu me naj shok tonin ose u konë i dënum burg ose a din, s'ke pasë vullnet me punu. Jaa.

Anita Susuri: Unë e di që për shembull minatorët tjerë qysh kanë tregu nuk kanë hyp edhe shumë nëpër autobusa, nëpër... jonë tut mos po i nxen policia.

Isuf Peci: Po, po, ajo u konë ndjekje, *auu* {onomatope} thash sistemi u konë atëherë, u dufke me u ru, bile shumë ju kena tregu edhe thojshin, "Osht' patrulla e policisë" në autobus m'u konë u dufke me zhdryp me ikë ose m'i ra malit me ardhë në punë. Ndjekja u konë kështu, në përcjellje, në vëzhgim jena konë nonstop 24 orë. Bile mu atëherë kur më çunë në burg, më kishin pa lyp, më kanë arrestu te Dedin Krš që thojmë na.

Anita Susuri: Në cilin vit ju jeni arrestu?

Isuf Peci: O nuk më kujtohet vallahi.

Anita Susuri: Mas marshit, a mas...?

Isuf Peci: Mas marshit, po, po. Kur u konë qaj aksioni për arrestimin e minatorëve qatëherë, qajo data qaë'herë u konë mu te Dedin Krš më kanë nxënë edhe më kanë çu në Zveçan. Se unë i asaj komune, më rrehen pak në kerr, tani edhe aty më rrehën, tani e kisha pasë vendimin. Bile po ma bon ai shkau tha, "Të kena lyp" tha, "të kena lyp për qiell e tokë, qe të nxunëm këtu". Tha "S'kemi lonë vend pa të lyp". E drejt në burg. Kur më çunë në burg, ish konë ni shiptar aty, thashë, "A bon me ju kallxu në shpi..." se sen të Zotit, kur më kanë arrestu ish konë kerr civil edhe unë s'e shtina menen, prej se zhdrypa prej Lipe atje në kamë pak pa hi edhe dy hapa me hi në urë aty te Dedin Krš unë isha pshtue.

Kur po e ni një ushtimë të Nivës⁴, se Nivat edhe Gazikat⁵ e kanë pasë ni ushtimë, e kanë si të veçantë pak. Kur u ardhë *rrsht* {onomatope} ma ka pre kështu, "*Lična kartu*" [srb.: Letërnjoftimin] tha, ja

⁴ Lada Niva e quajtur më parë Lada 4 × 4, është një automjet i projektuar dhe prodhuar nga prodhuesi rus (ish-Sovjetik) AvtoVAZ posaçërisht për tregun rural, megjithëse modelet e bëra shiten edhe për përdorim urban.

⁵ Automjet sovjetik që përdorej jo vetëm si mjet transporti për ushtrinë, por edhe për ekspeditat gjeologjike. Ishte mjaft rrezistent dhe mjaft i përshtatshëm për rrugë të vështira.

dhashë. “Auuu” {onoamtope} tha, “Jena tu të lyp për qiell, të gjetëm për tokë bre. Hin në kerr!” M’i ka dhonë nja dy grushta më kanë çu në Zveçan. Në Zveçan u konë nifarë milici, nifarë kmeti⁶ u konë, çetnik u konë, m’i dha nja dy grushta, vendimin edhe drejt në burg.

Kur më çunë në burg ish kon nji, aty, milic i burgut, nifarë Xhevati i Cerrajës, thashë, “Xhevat, kallxoju sontë” se dajtë i kom në Kushtovë të Vllahisë e Cerraja e Kushtova në Leposaviq janë ngat a ngat. Thashë, “Veç shko kallxoji që Isufin e kanë arrestu se bohën marak te shpia”. Edhe tajshi, ai nuk kish pa shku edhe baba jem mas tri-katër dite u bo marak u shku ka vet, i kanë thonë, “Isufi o në burg”. Tanaj edhe në burg kom vujt, më kanë rreh, me shokë në qeli më kanë çu, e qashtu.

Anita Susuri: Juve ju kanë arrestu për shkak të marshit a po?

Isuf Peci: Po, po, për shkak marshit.

Anita Susuri: Qajo u konë?

Isuf Peci: Jo, na kanë pa arrestu se tri ditë që dalshum në protestë, veç jonë konë tri ditë që dalshim bojshum grevë këtu rrishum në minierë. Njifarë mënyre refuzojshim punën.

Anita Susuri: E kur u konë qajo që keni hi në grevë mas marshit a?

Isuf Peci: Po, mas marshit.

Anita Susuri: Që s’keni hi në minierë...

Isuf Peci: Po, po, po.

Anita Susuri: Sa veta jonë konë të akuzum qashtu si ju, a e dini?

Isuf Peci: Për 30-60, po nja 70-80 për qind, gati krejt minatorët e “Trepçës” e kanë vujt.

Anita Susuri: Po veç kon e kanë nxonë...

Isuf Peci: Po e ka pas ni letër, i ka ardh urdhëresa për mi arrestu edhe e kanë arrestu edhe...

Anita Susuri: Kon e kanë nxonë e kanë arrestu...

Isuf Peci: Po, s’u pshtu, po, po.

⁶ Kmet - fshatar i respektuar, fermer i zoti, mikwpritws i mirw.

Anita Susuri: Tjetër, qysh ka qenë burgu për juve, sa keni qëndru?

Isuf Peci: Burgu ka qenë... 30 ditë. Burgu ka qenë, kështu ka qenë pak interesant për mu, Shera u konë, zëvendësi i Sherës ka qenë Paviqeviqi i Zubin Potokut. Edhe kur më kanë çu në burg, gjoja se për minatorë na e mundësun nifarë ode u thirrke, me dalë ditën me nejt veç minatorët përjashtë, jo në dhoma të burgut. Une jom konë në kohën e Ejup Statovcit kur ka qenë, qetij Adem Salihit që u konë që osht' kryetar i, që u konë i Ferizajit, qeky Adem Salih, Ejup Statovci rektor u konë. Atëherë qajo faza u konë që profesorat e shkollave të mesme që ja u refuzojshin plan-programin e Sërbisë, qata që e refuzojshin qata i dënojsin.

Edhe jom konë me do të Kaçanikut na kanë çu në odë, u konë ni minator i Kçiqit, nifarë Sejdia, ai u dekë i ndjeri. Edhe ata Sigurimi Shtetnor e kish pasë pagu ni magjup⁷, ardhke aty rrike {shikon mrapa vetes} pike duhan, nuk folke kurgjo, veç na inçizojke neve kush çka po fol, çka po organizon. Edhe kur shkoj une, na qitën prej burgu aty, ditën në atë dhomë ishin bo dhe. Ai Sejdia s'e hiçke plisin e bardhë kurrë edhe thashë, "Çka kini bre? Çka jeni ra në bele? Çka kini kështu, çka u bo?" Tha, "Vallahi bre Isuf qai" tha, "ja shajti plisin Sejdisë", thashë, "Kush bre?" Thanë, "Qai". Thashë, "O magjup aga" magjup i thashë. "E pse po ja shanë ti plisin?" E kom rreh atë magjupin.

Magjupi e ka kapë nifarë kaçketi {bën sikur heç nga koka kapelën} e ka pasë, e e ka shti në xhep e ka shku e ka thirrë Paviqeviqin, e u ardhë Paviqeviqi. Kur ka ardhë Paviqeviqi, tha, "Krejt që jeni këtu në rresht me dal ëatje", e tha, "Kush o Isuf Peci?" Thashë, "Une". Tha, "*Izadi*" [srb.: Dil], ma shajti nonën. E më ka marrë prej atyhit e më ka çu në qeli, më kanë rreh. Në qeli kom nejt 48 orë aty, um kanë rreh në qeli, mas 48 orëve më kanë marrë, kurrë nuk e harroj, ni polic shiptar tha, "Pash Zotin, po të thërret Paviqeviqi" tha "Mos fol aty se po na dhimësh po të rreh".

Më rrehi fortë, qaq fortë më rrehi që më shtrejti në pod edhe ma qiti atë kopaçkën, atë far çizmen këtu {anon kokën, prek faqen} tha, "Ku e ki Burhanin edhe Azizin?" Tha, "Kqyre ata janë bo milionera" tha "po manipulojnë me ju". Thashë, "Une nuk tërhekna pi atyhit". Edhe mas asaj kohe tash unë nuk e kom ditë çka u bo, u ardhë kjo për Kryq të Kuq, për të drejtat e të burgosunëve ish kon pa ardhë, nuk kom ditë, e i kanë vet aty. Tani këta kishin pa bo grevë, të burgosunit. Edhe kur kanë bo grevë ja kanë refuzu ushqimin, nja dymbëdhjetë orë s'kanë dashtë me marrë ushqimin. E tani i kanë mashtru diqysh e e kanë marrë atë shqyrtimin tajshi qashtu.

Anita Susuri: Ju tani mas 30 dite thatë që keni dalë prej burgut, domethonë 30 ditë...

Isuf Peci: Po dola prej burgut. Tanaj kur dola prej burgut, tanaj ja nisën prapë me na thirrë në punë, mos gabofsha. Po këtu thojke, "Ky ish i ndershëm, ky ish i pandërshëm". A din, qai që u qart e u konë kundra tyne nuk kanë dashtë me marrë në punë. Po tanishi falë shokëve tonë që kanë depërtu para neve këtu, i falënderoj ata shokë shumë, na kanë ndihmu neve që kena metë jashtë pune, që thojke,

⁷ Formë derogative e të referuarit komunitetit Rom.

“Jo thirre ato, është i nevojshëm. Jo thirre edhe ato, thirre”, tanaj hinëm apet në punë këtu. Po, kur erdhëm tanishi nuk kish hare, nuk kish gëzim, nuk kish prodhim, nuk kish lezet kurgjo. Edhe kur u bo me të 2. 08. ‘90-ën, kur erdhëm në sabah e kishin pasë bllokue njësia speciale e Sërbisë, krejt helmetat verdhë he bir, trupi më tërqethët, me pizgavera. Asnjo s’e kanë lonë me hi këtu mo!

Anita Susuri: Mas grevës?

Isuf Peci: Po, mas grevës, mas greve.

Anita Susuri: Unë deshta tash te pjesa... me fol për grevën...

Isuf Peci: Po jom konë në grevë.

Anita Susuri: E qajo ditë, po më doket 20 shkurti u konë, a po? 20 shkurti?

Korab Krasniqi: Mhm [pohon].

Anita Susuri: Qysh kena ni na, masi e ka kry ndërrimi i tretë punën ka metë në zgafellë...

Isuf Peci: I pari u hi, nuk u dalë, ju ka bashkangjitë i dyti, i treti, ren.

Anita Susuri: Po, qysh u konë qajo ditë edhe paraprakisht a u fol që ka m’u bo greva, a ka pasë naj organizim?

Isuf Peci: Jo, jo, shumë njerëz nuk e kanë ditë.

Anita Susuri: Ju a e keni ditë, ti a e ke ditë?

Isuf Peci: Une s’e kom ditë {mohon me kokë}. E pranoj s’e kom ditë, po si janë mbyllë ata meniherë e kom marrë helmetën edhe kom shku në të dhetin horizont edhe ju kom bashkangjit tajshi kanë qenë ato organizimet e grevës gjithkon nuk e kanë lonë me hi a din.

Anita Susuri: Qysh e kuptove ti që po bohet greva?

Isuf Peci: A meniherë e kuptova, qysh jo (buzëqesh). Tha, “Janë mshelë në grevë”, tha, “Nuk jonë dalë” tha “minatorët”. Thashë, “Pse?” Ttha, “U kry, ishalla përhajr”. E tajshi...

Anita Susuri: Në cilin ndërrim je konë qat’ ditë ti?

Isuf Peci: Une kom punu veç në të parin ndërrim. Veç në të parin ndërrim.

Anita Susuri: Edhe qysh tash, ti shkove poshtë...

Isuf Peci: Shkova poshtë. Jom bashkangjitë atyne, tani u dufke ato, jonë disa rregulla aty. Jom konë kujdestar te korpa mos me lonë gjithkon me dalë atje, mos me dalë, çka po bojnë që me... a din, ato jonë konë krejt organizime.

Anita Susuri: A munesh me na tregu prej ditës parë çka të kujtohet krejt, domethonë qato tetë ditë sa u konë, prej secilës ditë çka të kujtohet qysh ka ecë greva?

Isuf Peci: Kqyre, ka qenë gëzim m'i thonë dikujna gëzim, edhe shoqnia e mirë. E kena, une për veti e kom ni vetën krenar që jom konë, as s'jom tutë. Ka pasë organizim ma së shumti në fillim atëhere, se me të thonë të vërtetën krypa po të majke shumë. Kom ni prej baballarëve tonë, krypa fort po ta zgjatke, kogja p'e zavendësojke bukën. Ujë me kryp kena asi dej ja nisën ato tash. U konë organizimi i grevës u konë i mirë. U konë në nivel edhe me... i falënderoj edhe mjektët që jonë konë edhe krejt.

Po kur na u bashkangjit, na përkrahën edhe studentat u konë mirë greva. I lodhshëm, plogësht se greva edhe miniera nuk prodhon diçka mirë veç sëmundje glukozë. Ma së tepëri kena pasë problem aty me tension, ka pasë rast që i ka dekë dikush ose smutë edhe nuk u dalë. E kena dhonë, jena pa betue, tani na përkrahën krejt poplli e ju, e babballarët e juve, nejse ju nashta jeni konë ma të vogël, po na përkrahën krejt poplli, po kur na u bashkangjitë edhe fakullteti mo s'pat aty mo.

Anita Susuri: Në cilin nivel ke qenë ti, ke qëndru?

Isuf Peci: Qysh?

Anita Susuri: Në cilin nivel ke qëndru gjatë grevës?

Isuf Peci: Qysh nivel s'po kuptoj...

Anita Susuri: Për shembull... horizont, më fal.

Isuf Peci: Në të dhetin, në dhetin horizont jom konë. A i teti u konë boshti kryesor aty, jonë konë ata. Po u shpërndajshim ka pak, u kotshum ka pak. Po ma së shumti kena lyp ku ka pasë, te pusorja ju kena vyjt, te pusorja për ajër, oksigjen se atje edhe ka qenë në nivel se me pasë nalë ventillatorët, ventilimin na s'kishim mujt as gjashtë orë me nejt aty se na kishin mytë mizat.

Anita Susuri: Domethonë janë konë njerëzit që kanë ndihmu.

Isuf Peci: Po, po organizimi u konë në nivel. Me rrymë, me telefona, me krejt, po në atë kohë mu, tajshi u pa mungesa që e ceka unë edhe ma herët, u konë kërkesa unë me dal nalt me punu për drejtor e për minatorë, me kallxu krejt kush po thërret e qysh po thërret. Tanaj mu më qitën nalt. A edhe këtu jom konë {kthehet majtas} se e patëm pa bo të improvizum ni spital qitu {tregon me dorë majtas}, u konë spitali i improvizum qitu edhe aty kom nejt kom marrë ushqim artificial, qitu {kthehet me trup majtas dhe tregon me dorë} nalt. Po edhe këtu jom konë.

A prej aty mo nuk më lanë me hi, thanë, “Mos hi ti, Pec” tha, “Po shko në centrallë po të lyp drejtori Burhani” tha. Për me përcjell gjendjen atje kush po thërret e qysh po thërret, e cili numër po thërret ma së shumti. Se unë e kom pasë tabelën, centrallën e kemi pasë të montume të Sllovenisë, të Iskrës, e aty cilin telefon e çojshë, 400 telefona jonë konë, krejt në nivel këtu. Veç u dhezke drita edhe une ngojsha kush çka po fol, çka po thotë edhe i kallxojsa drejtorit.

Anita Susuri: Sa ju paska ra me nejt në grevë, sa ditë? Se po thu që je smu tani mo ke vazhdu...

Isuf Peci: Nja katër-pesë ditë kom nejt unë, po, pesë-gjashtë ditë. Edhe këtu kom nejt nja dy-tri ditë {tregon me dorë majtas} edhe tajshi dola naltë. Um qitën, se unë apet deshta qashtu smutë. Thashë, “Po shkoj qatje po vdes” tha, “Jo, jo, jo ma kryesor je ti atje se këtu”. Tani u dekë edhe ajo, shqiptare Shefkia u konë, e kanë pa çu aty se krejt sërbe jonë konë, sërbe jonë konë të Gojbulës, të Zveçanit që kanë punu në centrallë, në telefoni aty. U konë vend kyç për qato punë.

Anita Susuri: Cilën ditë të grevës kanë fillu me vizitu mediat kur ka fillu greva a po të kujtohet kur ka fillu me marrë bujë ma shumë, me ardhë politikanët?

Isuf Peci: Kqyre ma së shumti une po thom, ma së shumti që jonë ardhë, jonë ardhë qaty. Se qaty u konën ata akterët kryesorë në tetin, që qaty ardhshin ma së shumti këta, Stipe Shuvari e, këta qaty ardhshin. S’janë ardhë bash menihere, mas nja katër, pesë dite valla, s’janë ardhë ma shumë se tentun me na rrejt dilni e s’dilni e.... Po edhe ata e kanë pasë fshtirë, nuk kanë guxu bile shiptartë s’kanë guxu vallahi pa izë tyne, pa ardhë a din, se jonë konë të përcjelltë bre, u konë qasi sistemi u konë. Po harroj shumë une, kqyre 30 vjet bre nuk osht’...

Anita Susuri: Ju i keni, i kanë përpilu edhe këresat...

Isuf Peci: Kërkesat une i kom harru jonë konë 12 a 13, veç kërkesa kryesore që jena mashtru u konë dorëheqja e Hysamedin Azemit, Ali Shukrisë edhe Rrahman Morinës. Rrahman Morina ka pasë takime me... kur më çoi mu Burhani në centrallë, se dera jeme e centrallës u konë qitu {spjeron me duar} e Burhanit qitu, e majtën mledhje erdh Rrahman Morina. Kurrë nuk e harroj kur ju kërcnue Rrahman Morina, Burhanit, i tha {levizë gishtin tregues} “S’kije qare pa i qit punëtorët qysh i ke shti mrena!” Tha, “Ja kom me t’i nxjerrë” tha, “thojtë me dana” tha “kom me t’i nxjerrë”. “Eh more, Rrahman Morina” i thotë, “ti në jetë s’ki m’i nxjerrë ata” tha, “as s’ki shans”. E janë sha në nonë qaty, edhe u prish

mbledhja. Une e kom pasë derën çelë i ngojsa {bën sikur hap dorezën e derës}. I ngojsa edhe e përcjellsha gjendjen kush po fol aty në centrallë. A di tash më erdh mu ni polic, civil ish konë nuk e ngjo tha, “*Zatvori vrata!*” [srb.: Mbylle derën] tha, “*Šta slušaš tu?! Nije za tebe.*” [srb.: Çka po dëgjon aty. Nuk është për ty]. Kjo u konë.

Anita Susuri: Ju kujtohet domethënë që ai u konë aty?

Isuf Peci: Po, ai {lëviz gishtin tregues} tha, “Kom me t’i nxjerr” tha, “thojtë” tha “kom me ti nukë me dana” tha “që nuk i qet” tha “punëtorët përjashtë”. Tha, “Kurrë në jetë nuk kom me i qit, as asi...” tha, “Ti s’je hiç kërkushi për mu”. Po edhe i ndjeri u konë ky Azizi, Azizi edhe u ardhë na ka dhonë, na ka dhonë edhe shpresë, na ka dhonë edhe fjalë kena pasë krenari na poshtë atje. Paj vallahin, ma mirë e kena çu atje se jashtë edhe në familje. U konë atmosfera qasi tipi.

Anita Susuri: Gjatë grevës?

Isuf Peci: Gjatë grevës u konë, se vullnet ke pasë, kallxojshin vica, kallxojshin përralla, kallxojshin gjithçka ktyneherë a din, na ka majtë qajo shpresë. Na ka majtë qajo biseda e atëhershme, jena konë të lidhtë.

Anita Susuri: E çka keni fol për situatën, a keni mendu që keni me gjet zgjidhje?

Isuf Peci: Vallahi na mashtrun, menum që u plotësun qato dëshirat tona, qato kërkesa po nuk u plotësun ato. I kishin pa pru do vërtetima fallc, thanë, “Jo dhanë dorëheqje këta”, masi dhanë dorëheqje tani na qato kërkojshum, edhe këto nuk asi. Dolëm, si jena dalë na e kena liru atë natë këtu të nesrit e kanë bllokue s’na lanë mo me hy. Qai qëllim ish konë i tyne.

Anita Susuri: Domethonë ju masi kena dal këtu nalt, qysh u konë këtu nalt situata, a ka pas polici a?

Isuf Peci: U konë e zymt edhe e zymt u konë situata edhe nuk pajshim gjo na ra diqysh si terri pulave, nuk i pashëm gjinën kështu nuk i pashëm veç për krahësh na çojshin te mjeku. Dikujt i dhojshin injeksion, dikujt shtypjen, dikujt... nuk u konë bash lehtë gjithë në dritë, në dritë, në dritë me nejt.

Anita Susuri: E këtu polici a ka pasë?

Isuf Peci: Ka pasë civilë ma shumë, kur jena dalë na ka pasë atje te porta ka pak, po civilë e inteligjencë ka pasë në çdo skutë, e kanë përcjellë gjendjen. Të nesrit në sabah u blloku “Trepça” mo, nuk munëm me hi kërkush. Qata ni grup u hi 70 e diçka mos gabofsha ajo grupa që u thirrë, une jom nisë me ju bashkangjitë apat asaj grupe, um kanë arrestue te hymja policia nuk më ka lonë mo me ndërhy. Se ka lonë mo kërkon, s’ka mujt me hi me ta atje. Që i nxorrën me dhunë, nashta ju kujtohet

atyne, unë s'jom konë pjesë e asaj, atij grupi, a herën e parë po. Ata që u ngujun për lirim e këtyne që i burgosën, këtyne 12-13 vetëve. Burhanin, Azizin, Lazër Krasniqin, Azem Vllasin edhe shoktë tonë.

Anita Susuri: Ajo u konë në vitet '90-ta?

Isuf Peci: Po.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Kur u kry greva...

Isuf Peci: Këtu? {tregon me dorë majtas}

Anita Susuri: Po. E di që këtu u konë ai spitali, i kanë trajtu...

Isuf Peci: Po spitali i improvizum a qysh po thirrët, po, po, po.

Anita Susuri: E tash nesrit meniherë...

Isuf Peci: E kanë blloku, se nuk e kanë lonë me hi mo kërkon hiç, e bllokun policia.

Korab Krasniqi: Pse u dashtë ti me shku te mjeku?

Isuf Peci: Po ma së shumti shtypja na munojke, tug na ardhke, a din, plogshtë, pa gjumë, a në nivel u konë. Po kush ka pasë edhe naj kronike, naj sëmundje kronike ajo ka ndikue, boll ka ndikue për to.

Korab Krasniqi: Kur dole ti me shku te mjeku, a u dashtë me të ndihmu dikush a shkove vet?

Isuf Peci: Po, po më çunë aty edhe më çunë në qat spitalin e improvizum. Bile, kurrë nuk e harroj erdhën mjektë e spitalit, qetash u dekë ai i zemrës u konë i Mitrovicës, sivjet u dekë, internist i njoftshëm u konë ai, po ja harroj emrin vallahi qysh u konë, erdh aty, Basria edhe po u konë Basri Pllana. Basri Pllana që sot jeton në Sërbë, ju kom avyt ngat edhe ai tha, "S'jeni kurgjo anena, veç po rreni" edhe tanaj e shajtëm *auuu* {onomatope} punëtorët e qitëm përjashtë ato. Tani masanena u ardhë ni delegacion, Islami e ka pasë emrin, sivjet u dekë internist i mirë u konë, sivjet u dekë. Merre me mend qat' gjendje u konë edhe ai vdiq në nifarë shupe, as s'kish pasë shpi, asgjo të vet. Dej vonë kom lu shah me to.

Anita Susuri: E pse po thoni, ka qenë kundër juve a qysh?

Isuf Peci: Po Basria kundraj neve ka qenë, sot jeton... vëllau, e ka vëllaun, e ka vëllaun, as vëlla po, vëllau i tij po pëson tash, qysh thirrret kjo bre, kjo lamia që s'muj derdh ujë e, a din për bubreg e, për veshkë e qysh thirrret ajo...

Korab Krasniqi: Hemodializë është ajo për veshkë që e bojnë.

Isuf Peci: Jo, jo, ajo qysh thirrret, aty u konë Musa Miftari, u konë bash tash osht' në penzi. E osht' vëllau i tina s'di qysh e ka emrin. Eh, Basria u konë kundër neve, sot e asaj dite u ikë ai në Sërbi atje.

Anita Susuri: E deshta me ju vet tashti e di që në fillim ka pasë edhe sërbe që kanë mendu që është greva për kushte edhe kanë qenë pjesë e grevës.

Isuf Peci: Po dej vonë kanë qenë po kur e hetun kanë dalë, krejt jonë dalë, osht' e vërtetë kjo (buzëqesh). Shumë e vërtetë se qyre kajherë u dashtë edhe me rrejt jo me kallxu krejt ato planet tona. Thamë, "Bashkangjitnu neve se na e kem për kushte për qesi" tha, "Oo" tha, "nime, ani hini". Kur e hetun, kur u bo pesë minuta krejt jashtë janë dalë. Edhe dikur tanishi dulën edhe nuk ardhshin ata në punë. Filloi m'u acarë puna mo, ata e livdojshin në atë kohë, në atë kohë u konë Milloshi u konë shumë në fuqi të madhe, ka pasë, popllin e ka pasë në atë kohë mas veti, a din. Fillunë ato provokimet e tyne, disa sërbe i vnojshin ato shubaret veç s'di sa herë nifarë shkau të Bosnjes ja pata dhezë shuplake ja pata gju atë farë shubare, s'di qysh sëm kanë arrestu. Tajshi dikur i thanë, "Hiqe se p'e acarë punën". Filloi bre puna u prish mo, u prish ajo.

Anita Susuri: E a ka pasë shiptarë që nuk jonë konë për grevë? Ose që s'jonë bashkangjitë?

Isuf Peci: Paj vallahi ka pasë, ka pasë po kur e panë që 90 përqind shiptartë ma në fund edhe ata u bashkangjitën. Po qysh jo, qysh s'ka pasë.

Anita Susuri: Ka pasë shumë kolegë a qysh? Çka, çka ka qenë mendimi i tyne, pse mos me bo grevë?

Isuf Peci: Po u tutshin se u konë sistem komunist, atëherë jonë konë anëtarë të Lidhjes Komuniste, atëherë deshte s'deshte... në fillim pak parez e ceka atëherë që, se sistemi u konë qasi tipi, sistemi u konë i imponum, në atë sistem u konë që... kur e ka marrë Komiteti, se Komiteti përpara ka qenë organizatë që i ka vendosë edhe drejtorat në firma, i ka vendosë edhe njerëz nëpër pozita edhe krejt. Kur e ka dhonë ai për ni vend ose ni pozitë pa dhonë Komiteti nënshkrim s'ke mujt me përparu ti, shancë teorike s'ke pasë, ja-a.

Anita Susuri: Sa jeni konë ju aty mrena a i keni ditë këto ngjarjet politike çka kanë ndodhë, se Millosheviqi pat' ardhë në Kosovë...

Isuf Peci: Po, po i kena ditë, lidhjet i kena pasë na, qysh jo. E dishim kush po vjen, e kush po fol, e kena ditë na kush po vjen poshtë e kush...

Anita Susuri: Se ju e keni lyp Millosheviqin me ardhë, po ai s'ka ardhë e ka çu Stipe Shuvarin.

Isuf Peci: Jo, ai s'ka ardhë, ai u nda. Po atë ditë erdhën bashkë me Stipe Shuvarin, ai shkoj atje, majti atje...

Anita Susuri: Në Fushë Kosovë a?

Isuf Peci: Në Fushë Kosovë.

Korab Krasniqi: Në Gazimestan.

Isuf Peci: A në Gazimestan, a Fushë Kosovë, mos gabofsha.

Korab Krasniqi: Jo, niherë e ka pasë në Fushë Kosovë, mandej u ardhë në Gazimestan.

Isuf Peci: Po, promotori i krejt këtyne, promotori i krejt këtyne, bashkëpunëtori i krejt kësaj politike ka qenë Sholloviqi. Sholloviqi ka qenë organizator i krejt këtuhit, i Kosovës, Fushë Kosovës. Tani prej sistemi më doket e kanë largu ata, në Nish diku kom dëgjue, ai ka qenë tu i marrë urdhëresat me tollovi, me tubime ka qenë e atë ditë u ardhë. Milloshi nuk erdh këtu, ai, po mirë thashë Milloshi, erdh Stipe Shuvari. Stipe Shuvari u konë i mirë, u konë, Stipe Shuvari mos gabofsha kryetari i Kryesisë të RSFJ-së, u konë atëhere, u konë kroat. Une pak në film, mos gabofsha se po harroj kogja, Kroacia edhe Sllovenia gjithmonë na ka përkrahë, Millan Kuçani⁸ na ka përkrahë atëherë në Dom Cankar⁹ qysh thirrët ajo, ka pa fol shumë mirë për neve tha, “Po i mbron” tha “Jugosllavia të drejtat jugosllave” tha “në minierë të Stari Trgut”. A Sërbia na thojke, irredentista, shovinista e qishtu.

Korab Krasniqi: Dashta veç me të pyt për këtë punën e, punën e kërkesave...

Isuf Peci: Po, po.

Korab Krasniqi: Çka keni fol aty kur e keni përpilu listën me kërkesa? Çka keni fol, çka jonë konë diskutimet e juja?

⁸ Milan Kučan (slllo.: Milan Kučan, lindur më 14 janar 1941) është një politikan Slloven që shërbeu si Presidenti i parë i Sllovenisë nga 23 Dhjetor 1991 deri më 22 Dhjetor 2002. Para se të ishte President i Sllovenisë, ai ishte Presidenti i 13-të i Presidencës së SR Sllovenisë nga 10 maj 1990 deri më 23 dhjetor 1991.

⁹ Qendra Cankar ose Salla Cankar (Sllovenisht: Cankarjev dom) është qendra më e madhe e kongresit, dhe qendër kulturore sllovene. Ndërtesa u projektua nga arkitekti Edvard Ravnikar dhe u ndërtua në skajin jugor të Sheshit të Republikës në Lubjanë midis 1977 dhe 1982.

Isuf Peci: {Shikon i hutuar}

Korab Krasniqi: Në horizont mrena në grevë kur jeni konë...

Isuf Peci: Po pa u plotësu ato...

Korab Krasniqi: Çka keni fol ju, qysh jeni marrë vesh?

Isuf Peci: Une, une, une masanej i kom lexue, po në përpilim bash qaty nuk jom konë.

Korab Krasniqi: Nuk je konë.

Isuf Peci: Nuk jom konë, tash duhet m'u konë real. Edhe une menoj që nuk ka pasë shumë njerëz aty, me plot përgjegjësi po e thom këto, tjetërkush i ka bo ato, dikush ma i madh osht' ai, po unë nuk e di. Po lexu i kom, jonë konë ato kërkesat edhe jena marrë vesh që pa u plotësu qato kërkesa na mos me dalë prej miniere.

Korab Krasniqi: A je pajtu ti me kërkesat?

Isuf Peci: Po, po, po.

Korab Krasniqi: A ke pasë ndoshta naj kërkesë tjetër që ke dashtë me shti?

Isuf Peci: Po nuk ke mujt.

Korab Krasniqi: S'ke mujt.

Isuf Peci: Nuk ke mujt se kqyre, une edhe pare e ceka, gjithkush s'ka mujt me fol aty, jonë konë të organizum, organizimi ka qenë në nivel. Edhe nëse ka dashtë dikush me fol nuk e kanë lonë shoqnia se jonë tutë mos po gabon ose mos po sharron. U konë Avdi Uka, unë kom folë edhe shumë tjerë kanë folë, a po kupton, e kena ditë. Për shembull, me qeta {prek buzët} jena marrë vesh edhe me shiqim {shikon anash}, se ka pasë gazetarë e ka pasë tyli agjensie inteligjence. Veç e kena {shikon majtas} kqyr shoqi-shoqin qishtu, kush po folë filani, kanë hesht krejt e kanë ngue. Kur ka dashtë dikush që nuk u konë bash a din, nuk e kanë lonë. Qekjo ka qenë.

Anita Susuri: E pse nuk e kanë lonë, nuk po kuptoj?

Isuf Peci: Se ose jonë tutë ose po gabon, po ja shohum sherrin krejt, a din.

Anita Susuri: Domethonë, nuk e kanë lonë gjithkonë me fol.

Isuf Peci: Jo, jena pajtu me qato kërkesa edhe mo s'ka të folne aty, qajo ka qenë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Tashti ju thatë që keni dalë këtu edhe jeni marrë me terrenin jashtë, domethonë jashtë kësaj...

Isuf Peci: Miniere.

Anita Susuri: Prej minierës mrena domethonë. Çka keni pa tjetër na kallxut për qat' mledhjen që u bo po tjetër qysh ka shku dinamika këtu jashtë? A ka pasë edhe te Burhani që kanë shku delegacione?

Isuf Peci: Te ku?

Anita Susuri: Te Burhani, Burhan Kavaja, a ka pasë delegacione tjera?

Isuf Peci: Kanë pasë, njerëz të caktum jonë kanë kush me komuniku me Bajramin, me Burhanin dhe me të ndjerin Azizin. Po, po jonë kanë të caktum njerëz, po. Ai që u shkue e qata që e kanë pasë u kanë në pajtim me grevistë, ma së pari kur kanë dashtë me ardhë e kanë çelë poshtë a po pranojmë a s'po pranojmë. Kjo marrëveshje u kanë, jo me vendos dy-tre vetë për shembull çka të dojnë vetë se me nejt për shembull tetë ditë e me na shku poshtë diçka e kanë osht', qashtu ka qenë. Për shembull, u ardhë, "A p'e bojmë qeto, a pe bojmë a s'pe bojmë?" "Po-jo, jo-po. Koftë mirë, na bjen tonëve mirë, koftë keq ja pafshim hajrin tonë për keq", qashtu ka qenë.

Korab Krasniqi: Edhe pse u qujt grevë megjithatë këta grevistët kanë hongër, qysh jeni furnizuar me ushqim, a ka pasë uri aty a ka pasë mungesë të ushqimit?

Isuf Peci: Jo s'ka pasë mungesë, u kanë kqyre grevë po, po s'u kanë, kena pasë ushqim. Ushqimi u kanë në kohë të caktume, u kanë, a din në nivel u kanë, nuk kena hek, nuk kena hek keq. Po për shkak të zmadhimit, tash po folim real se a din nashta nuk osht' mirë me fol prej meje, grevë urie tetë ditë osht' zor dikush me... duhet me fol realitetin, kqyre unë muj të thom realitetin po s'osht' qashtu. Na ia kena ngjithë haku që me bo bujë ma të madhe në Evropë. Qat' intervistë unë që e kom dhonë në Dukagjin e kom dhonë ato meniherë e kanë shpërnda edhe e kanë dhonë franqezët, ajo ka pasë jehonë të madhe shumë.

Anita Susuri: Ju keni fol për media a po?

Isuf Peci: Po, po s'po muj e gjoj në Dukagjin atëherë sa i thatë jom konë në të dhetin horizont. Kom thonë, kurrë s'e harroj në gjuhë sërbe kom fol kom thonë, "1500 minatorë nuk dalim prej këtuhi, të dekun kena me dalë pa dhonë dorëheqje qeta me emër me mbiemër". Unë e kom ato, po s'po muj e gjoj tash kun. U konë do ditë, u konë në Dukagjin po tash s'po muj e gjoj ku osht'.

Anita Susuri: Më tregut ma herët edhe për ni person që ka ardhë prej Associated Press?

Isuf Peci: Po, une jom taku drejt me to. M'i ka dhonë dy asoshnë {formon rrumbullakun me gishtin tregues dhe të madh}, dy aso. Po tash, pak para se me shku në penzion ky gjenerali i ushtrisë ma ka dhonë ni asoshne {formon rrumbullakun me gishtin tregues dhe të madh}, domethonë e kom në shpi une. Une ia kom dhonë, ni kristall ia kom dhonë ma i mirë se qai u konë {kthehet shikon mbrapa}, u konë i madh.

[Këtu ndërpritet intervista]

Isuf Peci: Ai um tha, ai um tha bile kur erdh ish konë pantollt e çkyem, e kish pasë ni setër të çkyme me nifarë strajce, na strajcë i thojmë nifarë çante {bën sikur mban çantë}. Hini aty tha, "A bon m'u ungjë qitu?" Sërbisht, slloven ish konë. Po s'ish konë ai slloven, po ish kon i CIA-së a Zoti e dinë i kahit ish konë. Um veti qysh po shkon, unë ia dhashë informatat krejt, i dha ai prej qatytit, prej centralle i ka dhonë drejtë për drejt në Slloveni, Sllovenia i ka çkepë në botë. Edhe tha, "Po ti dho për kujtim qeto dy" tha, "maji në men" tha "kanë me të vy veç mos t'i nxe kush".

Anita Susuri: Çka jonë konë qato?

Isuf Peci: Ajo u konë *znaçk* [srb.: distinktiv] i lexojke Associated Press si këto që e ngjet këtu {prek xhepin e këmishës}. Si për shembull partisë politike a ke pa që e ngjet?

Anita Susuri: Po, po, po.

Isuf Peci: Qysh thirrën ato ju e dini ma mirë. "Qitu" tha, "maje", po nuk e kishin pasë atë ato që e qet këtu veç rrumullakun e kish pasë lexojke "AP". Tha, "Maje qeto se të vyn". Thashë, "Çka më vyn?" "Mos e hup" tha "ruju se po ta nxojnë se ja she sherrin". E i kom pasë shti në çerapë, në çerapë i shtina dej dola. Tani u zateta me qat mjekun, gjallë osht' sot, bile e kom pasë grun smutë tash në Prishtinë kur më ka pa ka kajt. Nuk dojshin me më pranu tha, "A p'e shihni qeto". thanë "Po" tha, "Për kon jena munu na" ja u shajke me nonë me kryetar. Ai sot osht', osht' internist i zemrës kryesor në Prishtinë Nexhmedin Zeqiri, i Llapit osht' ai aty, ja kom dhonë njo atij, m'u më ka hup.

Po tanishi edhe Kryqi Kuq kur u ardhë um ka lyp mu që më kanë rreh në qeli edhe aty Kryqi Kuq ju ka dhonë, ka thonë, "Jepjani qatij që o në burg qat *znaçk*" Kryqi Kuq ndërkombëtarë, me qat Kryq ndërkombëtarë gjashtë veta e kanë fitu azilin, sot janë me familje në Gjermani. E mu s'më kanë lonë

m'u taku, jom konë në qeli në atë kohë, tinza ja kanë dhonë, ja kanë lëshue, "Jepja" ka thonë, "atij Isufit qeto se i vyn". E kishin pa ditë që s'ka niherë këtu veç që kanë me na përzon, e kishin pa ditë të jashtit, krejt planet ishin konë qashtu.

Anita Susuri: Po ju tash që po folni është mas grevës që është mbajt një grevë për këta që janë burgosë a po?

Isuf Peci: Po, po.

Anita Susuri: Edhe një herë ju kanë burgos juve?

Isuf Peci: Filloi tani procedura, njëkja e minatorëve.

Anita Susuri: Kjo u konë mas grevës?

Isuf Peci: Po, mas grevës, po, po, po.

Anita Susuri: Për grevën a dojna me vazhdu hala me fol? [i drejtohet Korab Krasniqit]

Korab Krasniqi: Une veç dashta me pyt edhe diçka.

Anita Susuri: Po.

Korab Krasniqi: Për ditët në grevë sa jeni konë, jeni konë në horizont, jeni konë të ngujum për tetë ditë.

Isuf Peci: Po.

Korab Krasniqi: Dashta me ju pyt për aspekte higjienike qysh jeni kujdes?

Isuf Peci: Jena kujdes vetë, po jena kujdes falë Zotit që ka ujë atje, e jena pastru edhe jena, jena... qysh kena mujt. Unë tregova atë rastin, ka pasë raste jena shku tash në të dhetin u ra ata ujët qatje jena {fërkon kokën}, nxet, sapuna kena pasë jena pastru edhe qashtu po. Ronë o bre, ajri osht' i asit, higjiena u konë me ujë, me çka ka pasë nevoj, kush u konë smutë e kena qit, u konë njësia special. Edhe te korpa ka pasë njerëz kudjestarë nuk ka mujt kush don me hi edhe me dalë. Kjo ka qenë marrëveshje edhe nuk ka guxu njeri me thonë jo po boj qishtu, jo, jo.

Ai që ka tentu diçka e kanë qit' me dhunë edhe e kanë qit', jashtë porte e kena qit'. Se kena lonë, tyrli njeri s'kena lonë na aty, njeri të dyshimtë nuk kena lonë aty. Po nashta edhe ka pasë dyshim, ka punu për... ç'a po di une. Te telefoni u konë i përcjellun telefoni, telefonin nuk ka guxoftë propagandën edhe

të gjitha ato mediat e kanë fitue edhe na kena fitu shumë, nuk e kena lonë gjithkon me thonë çka don, çka me folë. Jashtë nuk e di qysh ka shku edhe jashtë ka pasë rregull. Në çdo resurs punues ka qenë ekipi special, ka qenë ekipi special i trafo-tensionit të lartë që osht' sot këtu, mos me na lonë pa ajër. Ka qenë i ujit, ka qenë ajrimi, ka qenë signalizimi.

Shumë raste une jom konë në grevë ka pasë defekt, um kanë thirrë une e kom ujdís telefonin e jom dalë, me marrëveshje o kjo kështu. Po kur e pamë që po dalin disa dezinformata edhe e ka hetu Burhan Kavaja më ka çu në centrallë nalt, kjo ka qenë. Atmosfera ka qenë në nivel. Une jom krenar, pasha qato ditë, po edhe me konë dekë isha konë edhe ma krenar, se edhe ata disa janë dekë, shumica nuk gjinden mo në këtë botë, ishalla Allahu i ka kurtalis, ishalla more Zot.

Korab Krasniqi: Në centrallë kur je konë, tha që i ke kontrollu thirrjet.

Isuf Peci: Po.

Korab Krasniqi: A ke, a ke pasë naj informatë interesante që ka qarkullu?

Anita Susuri: Ose naj propagandë e keqe?

Isuf Peci: Ka pasë disa dej vonë i kom dëgju unë qysh po folin, po dikur osht' ajo ja u dha një lajm, ju tregoi që jom tu i ndigjue e kur e hetojke që po i ndigjoj e mbyllke telefonin menihere. I tregoi dikush, kush tregoi nuk e di. Se atje u konë, për shembull, centrala u konë këtu {spjegon me duar}, u dhezke, krejt numrat jonë konë qitu të shënume si e ke çu ti qat {tregon me gisht majtas} telefon nalt {bën sikur ngreh telefonin}, qishtu si e ke çu t'u ka dhez drita edhe në mënyrë sekrete kom shku në centrallë atje e kom prekë nifarë pulle edhe kom ndëgju {mbështet kokën dhe bën sikur përgjon} krejt çka po folin. Edhe masanej e kom pasë detyrë me i lajmërue, i kom pasë gjintë e mi, "Filanit runu se qishtu osht', qishtu, qishtu po folë". Ma së shumti... s'po du me emra, ka të vdekun, ka edhe të gjallë, disa familje po i kom rue.

Korab Krasniqi: Qeto informata që i ke dhonë ti Burhanit e Azizit, apo veç Burhanit?

Isuf Peci: Përmes tjetërkujt ia ka dhonë Azizit ai, janë shku, nuk janë shku bash...

Korab Krasniqi: A u konë naj informatë kështu kyçe, e randësishme që ju ka nimu Burhanit për me e mirëmbajt situatën apo diçka?

Isuf Peci: Te une nuk ka ndodhë, pos qai rast që ka thirrë ai Bjelletiqi, ai u konë sekretar i Komitetit Qendror të Sërbisë. Ato e kom nxonë une edhe veç e kom lëshu telefonin, jom hi i kom kallxu Burhanit.

Korab Krasniqi: Çka ka fol ai?

Isuf Peci: Tha, “*Šta tražite bre?* [srb.: Çfarë po kërkoni] Çka po doni?” Tha, “A jeni në grevë?” “Jo more, çfarë greve” thashë, a në grevë ishin këtu. Tha, thashë, “*Izađe proizvodnja*, po del prodhimi” thashë. “*Ma kakvi*” [srb.: Po çfarë] tha. Se përpara ka qenë ni ditë mos me punu “Trepça” e ka marrë vesh krejt Jugosllavia, thu ti se u bo kumeditë çka, kiameti u bo, e s’u konë e jonja hiç, s’e kishim pa ditë na. E i kom kallxu thashë, “Kqyre Bjelletiqi filan njerin e lypi” edhe e ka lyp, masi ka fol me mu Bjelletiqi e ka lyp Julla Gashiqin.

Julla Gashiqi në atë kohë ka qenë kryetare e sindikatës e na shiptartë e çojshum qishtu {ngrit duart lart}, se kur ardhke në tubim ajo, para tubimi të punëtorëve e shajke Sërbinë, e shajke sistemin, i shajke, a ko e kish lidhjen me ta qishtu {bashkon gishtat tregues}. Prej që e kom zbulu, une thashë, “Kqyre ajo...”, bile Burhani u çudit tha, “Kon e lypi?” “Julla Gashiqin” thashë “e lypi Bjelletiqi”. Tha, “S’osht’ e mujtne” thashë, “E mujtne o, qysh s’osht’ e mujshme”. E aty mo e kena diktue edhe mo jena konë t’u përcjellë, nuk kena folë tani e hoqën Julla Gashiqin. Qishtu u konë, kjo osht’ e vërtetë, ma e vërteta osht’.

A na qishtu e çojshim përpjetë {hedh shishën e ujit lartë} Julla Gashiq! Gashiq! Se thojke, ardhke në tubim thojke, “Keni drejtë ju, keni...” e shajke Milloshin, kopil, veç me na zbulu neve çka po folim edhe me i ditë planet tona. Po kur e nxona une që tha, “*Daj molim te povezi me sa Jula Gašić dole*” [srb.: Të lutëm më lidh me Julla Gashiq poshtë] edhe e kom lidhë une e kom ndigjue. Po e ka hetue Julla, e kish pa mësue dikush, tha, “*Pece zatvori taj telefon*” [srb.: Peci mbylle atë telefon] edhe e kom mshelë une telefonin se... s’di qysh s’ëm shtinën në burg, se m’i ngu ajo ronë osht’. Bjelletiqi u konë, kurrë s’e harroj, u konë sekretar i Komitet të Sërbisë bash në kohën e Millosheviqit. Millosheviqi qat’ fuqinë e madhe e ka pasë, une e kom zbulu ato.

Korab Krasniqi: Ni pyetje prej asajna që...

Isuf Peci: Se nashta po foli shumë.

Korab Krasniqi: Jo, jo na për qat’ punë jena këtu. Ni pyetje që the edhe vet domethonë nëse ni ditë s’ka punu “Trepça” u bo e madhe...

Isuf Peci: Po, po, po.

Korab Krasniqi: E çka ta merr menja ty a e ka damtu greva juj tetë ditore që e keni matë, a e ka damtu ekonominë jugosllave apo jo, në atë kohë?

Isuf Peci: Po e ka damtue bre ti, se për ni ditë për shembull sa xehja u dalë, krejt qata pasuni e ka marrë Sërbia. Une edhe e kom ni rast me ta lidh qysh ka pasë peshë, nashta edhe nuk osht’ e rondë me thonë. Jom konë pasë shku ni kredit me marrë për shpi me maru se ta kallxova rastin për shpi e kom

marrë ni kredit në “Beobank” të Beogradit në bankë dhoke me kredit. Jom shku jom hi në Beograd, e masi e mora atë kredit për shpi diçka, hina në atë dugoj “Beko” u thirrë ajo firma e Beogradit, u konë ma e madhja në Jugosllavi për tesha, tesha ka pasë 300 euro si me i bo tash asi.

Edhe i kqyra, i kqyra... po du me lidhë çfarë vlefte ka pasë “Trepça”, krejt ketë bisedë p’e lidhi me “Trepçën”. Edhe hi aty thomë, më kqyri ajo tha, “Çka po i kqyr këto tesha?” Ajo shitësja në Beograd. Thashë, “Po, po i kqyri tek jonë të mira qeto tesha”, “Po merri bre”, thashë, “Po s’kom bre pare me i marrë unë” a din. Po, tha, “I kahit je, ku punon?” I tregova. Tha, “Ku punon?” “Në ‘Trepçe’”, {ngrit dorën lart} “*Ehh*” {onomatope} tha, “qetash ko me t’i palu me t’i shti në llastik”. Thashë, “S’muj” unë vet me veti qysh i shtini në llastik teshat.

Tha, “Ku punon?” “Në ‘Trepçe’”, “Ku punon?” “Në Stari Trg”, e i kallxova, veç ja kom dhonë lëtrnjoftimin, tha, “Gjysën e shitores” tha, “ta dho për ‘Trepçën’”. Se ka qenë garantues (qesh) qy, qy ka qenë garantues, garantuse e Jugosllavisë o vlla. Hej e jo për ni parë tesha të mia ç’a kanë kushtue. Po du me lidhë atë bisedën që the, a e ka dëmtue, e ka dëmtue sigurisht se krejt e kanë çu atje. Kosova s’e ka marrë as... s’po di sa me thonë po 70-80 përqind e ka marrë veç Sërbia, krejt e ka shfrytëzue. Kjo ka qenë, qysh jo.

Korab Krasniqi: Edhe ni pytje, the studentat jonë bashkangjitet, na kur i kemi kqyr gazetatat kemi pa që të gjitha fabrikat domethonë që jonë konë publike të asaj kohe jonë solidarizu me juve.

Isuf Peci: Po. Po, poplli.

Korab Krasniqi: Poplli, po, baba jem më kujtohet në atë kohë e përmendke që... baba jem ka punu në Komunë të Prizrenit, në fabrikë të këpucave edhe ata janë solidarizu. Mandej kemi pasë domethonë të gjitha që jonë konë, studentat, punëtorët e ndryshëm krejt jonë solidarizu me juve.

Isuf Peci: Po, po.

Korab Krasniqi: Qysh ka ndiku kjo kur e keni marrë vesh që po bashkangjiten?

Isuf Peci: Kena ndikue që kurrë ma krenar nuk kena qenë që e kena ditë që e kem popllin tonë edhe me ta thonë ni fjalë që faleminderit që e çele kët’ bisedë, në qat’ kohë që e kena bo na grevën aty ka qenë edhe në histori muj me thonë bashkimi kombëtarë i Kosovës. 99, 9 për qind krejt qaty jena bashkue {bashkon grushtat} edhe jena munue. Ata s’kanë mujt, këtu ka pasë edhe asi, kanë pru njerëzit në greva, more kanë pru gjithçka këtu ndihma neve. Po ka qenë ma së mirti që jonë bo me shpirt e me zemër, menxi s’kanë prit me i kqyr lajmet e Radiotelevizionit të Prishtinës, çka po ndodh. Me zemër e me shpirt tonë jonë konë atje, osht’ e vërtetë kjo. Po edhe ka qenë qaq fortë jonë lidhë në qat’ kohë ka qenë lidhja e kombit të Kosovës. Shumë e vërtetë osht’ kjo që po thom.

Anita Susuri: Kanë thanë që edhe pajtimi i gjaqeve ka fillu aty.

Isuf Peci: Na e kena nisë pajtimin e gjaqeve prej këtuhit, kena qenë pjesë edhe atëhere e s'di sa gjaqe i kena... në emën të qasaj kohe, të qasaj vështirësie që kena dhonë na kontribut për komb, e për Kosovë kanë falë edhe gjaqe, po osht' e vërtetë kjo, ti motër, e vërtetë është, qashtu është.

Anita Susuri: Mas... për grevën a ki mo najsen? [I drejtohet Korab Krasniqit] Deshta me pyt masi u kry greva qat' ditë edhe ju e kuptut që i paskan plotësu qato kushtet, që kanë nënshkru ata...

Isuf Peci: Po, u mashtrum.

Anita Susuri: Po të nesërmen a, kur u kuptu që ka qenë veç fallc. Qysh u prit qajo?

Isuf Peci: E kur erdhëm në punë, e u prit keq, u tradhëtum.

Anita Susuri: Çka ndodhi tani?

Isuf Peci: Pak u ftofëm na, po apet atë qëndrimin tonë, u ftohën ato, ato ai besimi u ftoh pak, po apet na kem këmbëngulës edhe mo hajrin s'na kanë pa, as prodhim s'kena qit. Edhe si na qitën e na kthyn e, s'punojshim mo qysh me thonë bash se e dishëm tani që... kur na largun neve krejt, krejt që e panë që s'bon i prunën xehtarët e Bosnjës e këto, e kishin pa ato ndërkombëtare, ato shtyllat kryesore të xehës që e majnë ato janë veç në rast të luftës kur don me falimentu shteti ato i shfrytëzojnë, i kishin pa shfrytëzu ato shtyllat e xehës kryesore, ajo osht' e ndalushme ndërkombëtarisht. Krejt e kishin pa marrë ata xehën, veç boshnjakë kanë pru, xehtarë boshnjakë kanë pru.

Anita Susuri: Juve kur ju kanë qit prej punës tani?

Isuf Peci: Une e di që me të dytin, thash me 2.3. '90-tën u konë mshelë, tani na thirrshin masanena, e neve na largun të '90-tën. Tanaj filloi emigrimi mo këtu, fillunë hetimet, s'kishum, na kapi edhe kriza.

Anita Susuri: Para sa me vazhdu anej. I kanë burgosë një numër të njerëzve tu e përfshi Azizin, Burhanin.

Isuf Peci: Po.

Anita Susuri: Edhe disa punëtorë tjerë.

Isuf Peci: Po 14 jonë konë ata.

Anita Susuri: 14 punëtorë, qysh, qysh e përjetut ju qato?

Isuf Peci: Rondë e kena përjetu, se prijësit na i murën udhëheqësat tonë na i murën, rondë u konë ajo. Shumë rondë ke, po u duft m'u pajtu. Apet vazhdon jeta.

Anita Susuri: E qat' ditë që s'ju kanë lonë me hi mo këtu, qysh u konë këtu situata?

Isuf Peci: Këtu u konë, kur kemi ardhë prej ko poshtit {tregon me gisht kahjen} e derkterti nalt krejt pizgavera të ri ishin konë edhe i kishin pa prur me na frikësu neve. Propagandë, i kishin pasë gjetë do policë ma të mdhaj ni metër e gjys-dy edhe krejt helmetat {prek kokën} e verdha veç vizlojshin, që veç me kqyr u rrënoqethshe. "*Ne može više niko tu, s'muni me hi mo këtu ansjoni*", filloi diferencimi, filloi arre... kjo farë burgosja, njëkja penale e qishtu. Tani na erdhum në krizë të madhe u deshtë me migrue. Une për veti po tregoj me mana jom metë masi na qitën, me mana, t'u shitë mana atje te na mana. Këpurdha kom shitë e, veç me metë gjallë, a i kom pasë... me thonë të vërtetën rondë u konë valla, tesha s'kena pasë, s'kena pasë këpucë. Këpucët i lidhsha me tel që m'u qkqyshin me tel i lidhsha, në qat' gjendje deri shkova në perëndim.

Anita Susuri: Qato vitet e '90-ta u bo edhe ni lloj greve që për këta të burgosunit a keni qenë edhe ju aty?

Isuf Peci: Që u mbyllën këtu a?

Anita Susuri: Po, greva dytë.

Isuf Peci: Po këtu s'em lanë mu me hi, unë tregova pak pare që më kthyen mu se pata apet m'u bashkangjitë. Ajo u bo për shkak që me i lirue këta të 14-tit, qaty u konë ajo. E këta i kanë nxjerrë me dhunë. Edhe këta krejt jonë konë... edhe i kanë rreh, tu i çu tu i rreh në burg, tu i çu tu i rreh. Po dhashtë Zoti, nuk i denun shumë i lëshun, filloi apet e qashtu. Veç vallahi a din qysh osht' kjo, kjo osht' sikur kur osht' njeri i smutë mo hajrin nuk na kanë pa, po të kallxoj drejt, a din nuk ke mo atë fuqinë, nuk e ka atë... edhe kjo teknologji e sodit osht' 70 vjeçare, moti u montu.

Anita Susuri: Në vitet e '90-ta thatë që keni emigru jashtë?

Isuf Peci: Po kom shku në Gjermani jom konë.

Anita Susuri: Në cilin vit '90 e...

Isuf Peci: '91-tën, '92-tën atje jom shku. Ika...

Anita Susuri: Shumë kanë shku qashtu shiptarë.

Isuf Peci: Po ka shumë në Suedi e me familje, sot janë metë aty.

Korab Krasniqi: A na kallxon qysh e dajte menjën me shku?

Isuf Peci: Qysh jom dalë?

Korab Krasniqi: Qysh e dajte menjën, qysh e bone me menë?

Isuf Peci: Po e dajta menjën, ma së pari s'kisha të holla, baba kallxova ma para nuk e ka pasë rrogën e mirë, dobët e ka pasë veç me na majt gjallë u harxhitën gjoja e këto t'u shitë për idare. U duft me emigrue edhe shkova në perëndim atje.

Anita Susuri: A ki familje të madhe, sa fëmi i ki ti?

Isuf Peci: I kom, i kom une katër fëmi. E kom djalin që dy vjet në Nju Jork, osht' tu punue i kom punët mirë.

Anita Susuri: E në atë kohë keni shku vetëm ju a krejt familja?

Isuf Peci: Vetëm. Jo, jo, vetëm pa familje. Nejta pak tanishi u ktheva, si u ktheva u kyça, më lypi apet qai vendi ku jom konë ma para në "Trepçë" e deri në pension.

Anita Susuri: E atje në Gjermani a keni punu punë të ngjashme si këtu?

Isuf Peci: Jo vallahi, jo vallahi (buzëqesh), jo motra jem. Atje kom punue me të thonë të vërtetën jom konë ni firmë ma të madhe në Evropë të thiut, ç'a s'ke ni ti thi. Dhetë mijë thi në ditë i kena bo operacion e i kena pakovat. Si e shtike thiun këtu në automat, qitu e shtike gjallë, qatje dalke në paketa "Enecef" u thirrë ajo, firma ma e madhe që ka ekzistuar në Evropë, në Gjermani u konë ajo. Kom punu edhe do farë qysh u thirrshin, në qet vakt dalin ato... shpageta, shpageta. Edhe aty kom punu, kena hjek shumë.

Anita Susuri: A u konë fshtirë me jetu atje si...

Isuf Peci: Valla pa punë atje u konë fshtirë, u konë fshtirë. Ju dhimsha atje kur ju tregojsha rastin që jom konë minator. Thanë, "Po na dhimësh" edhe çka o ma që po du me lidh, kom punu atje tri vjet e diçka me letra tanaj *ausifi* ju thojshin gjermanisht s'mujta me punue edhe erdh koha u ktheva edhe qashtu.

Anita Susuri: Na tregut që keni qenë i angazhum atje në atë "Tre përqindëshin"...

Isuf Peci: Po kam qenë atje i angazhum, meniherë kom fillu në legalitet me punu atje, e na kanë asi, kom qenë për qytetin tem për “Tre përqindëshin” kryesori që kena mledhë pare edhe për “Vendlindja thërret” edhe për “Tre përqindëshin” edhe krejt u konë organizim i kom dokumentat, kena punu për qet Kosovë të sodit.

Anita Susuri: Qysh shkojke ky organizim?

Isuf Peci: Shkojke, shkojshim derë për derë ma, problemi e kemi pasë me ashkali nuk dojshin me i dhonë paret e na e kemi pasë nifarë parolle që, “Nëse nuk i jep ti paret tash, mo s’ki çka kthehesh në Kosovë”. E ja u marrshin si me zor paret atynve. A shiptarët tonë kanë dhonë, 500 qashtu.

Anita Susuri: Ju e keni ditë krejt ku jonë ata, ku jetojnë?

Isuf Peci: Po, po, me adresë ju shkojsha me kerr atje në Berlin, thojsha, “Qekaq pare duhet m’i dhonë”. Për regjionin e Mitrovicës, për luftën e Drenicës i kom mledh nja 15 mijë euro në atë kohë, qysh jo. I kom krejt dokumentat në shpi ato, bile osht’ banka “Sparkasse” thirret e Gjermanisë atje, me ata çekat po.

Anita Susuri: E qysh merrshit informacione, a kishit kontakt me familjen, a folshit për situatën?

Isuf Peci: Po, po na tregojshin edhe lajmet. Lajmet i kqyrshim rregullisht qysh osht’, qysh po sillet gjendja qysh, po. Hupi dikur, kallxojshin s’kishin as këta as shitje mo as, u prish hesapi. Lujti qysh thojmë na katunarët me temel lujti shteti, lujti puna, lujti... I qitën prej punave, u demoralizun shkurt u prish puna.

Korab Krasniqi: Po qajo periudha e ndamjes...

Isuf Peci: Po, po ndamje me shokët.

Korab Krasniqi: Tepricë teknologjike i kanë qujt...

Isuf Peci: Po tepricë teknologjike, filloi s’di a e ceka ma parë, filloi edhe diferencimi tanaj, po ai u konë ma i keqi.

Korab Krasniqi: Këtë angazhimin tond me fondin e “Tre përqindëshit” edhe “Vendlindja thërret”, a e ke bo si aktivist politik i LDK-së?

Isuf Peci: E kom bo, i LDK-së po. A ni rast e kom bo këto veç human për “Vendlindja thërret” për regjionin se atëherë ish luftë në Drenicë, që ish lufta e Drenicës për regjion, ato e kom shkru “Për

region të Drenicës”. “Tre përqindëshi” e a ja ka dhonë a s’ja ka dhonë {çon duart lart} veç ai nalt e din. Këto po të thom realitetin.

Korab Krasniqi: A munesh me më kallxu qysh u konë për juve për familjen me e pa luftën në Kosovë prej diasporës

Isuf Peci: *Aaa* {onomatope} kajsha.

Korab Krasniqi: Qysh e keni përcjellë.

Isuf Peci: Une kom kajt.

Anita Susuri: Familja jote u kon këtu, ti vet je kon atje?

Isuf Peci: Po atje, kajsha. Une në telefon kur folsha çdo natë, se na i marshim lajmet i kqyrshim atje BBC-në e i kqyrshum krejt. Thojsha... se une në Boletin kom pasë gjo shumë, gjo lopë kështu a din. Thojsha, “O shitni lopët se do m’u bo luftë, shitni lopët se do m’u bo luftë” “Jo bre s’po folet kurgjo”, “Osht’ t’u fol, shitni valla se s’kanë çka me ju vye” edhe nime u bo luftë. Bili-bili ni rast e kom qet çikën që ma ka kry fakulltetin qetash, të mjekësisë, momentalisht punon në “Viva Fresh” zëvendës menaxhere osht’, tha, thashë nonën e babën me ma vra po edhe të gjallë jo, i kanë rrethu s’di sa herë, s’di sa herë Zoti i ka pshtue. Edhe tham, “Kqyre ma fali Zoti qet çikë” thashë, “edhe du me ja lonë emrin e nanës” thashë, “se ma vrapnë e kujtim”. Sot e ka, e kur erdha kho e zateta (qesh) fati edhe nanën gjallë. Tha, “Qysh me ja lonë për së gjalli emrin” thashë, “Vallahi nonë qishtu”, u dekë ajo kogja moti sot e ka emrin e nonës, Hanife e ka. Po vallahi edhe kjo ka ndodh (qesh), po tybe.

Anita Susuri: E familja ju a ka qëndru aty gjatë luftës?

Isuf Peci: Në Boletin kanë qëndru deri ma të mramin që e kanë shpërngul prej atyhit e atë masakrën që e kanë bo në Majdan. Tregojnë kur i kanë marrë me i pushkatu, i kanë çu të lidhun prej atyhit e deri atje, krejt më kallxojnë, e më kallxojnë atje poshtë... se na prej Boletinit e kena atë rrugën që shkon për Rashkë atje prej Grabovcit, thanë, “Shumë herë pushkë kena ni, kena menu që ka edhe varrëza qatje” nona tha, “Brimë ju shkojke” nona jem. Edhe kur e kanë bombardu qitu Majdanin {tregon me dorë majtas} “Flakë, xharaf ju shkojke” tha “Avionat e NATO-s i pajshum, he bir flakë” tha, “u kallke prej tyne”. Kur e kanë rrëzu qet antenën në Cërnugë që po folet tash që po dojnë me bo bazë ushtarake “He bir” thojke, “flakë e verdhë ju shkojke”. Ata prej kohit t’u kqyrë, msheft tu u palue. Po, po, po krejt më kanë kallxu.

Anita Susuri: Tani a kanë dalë në Shipni?

Isuf Peci: Jo, jo, s'kanë dalë. E kanë marrë plakun tem edhe kanë thonë, e kanë gjetë "E heku" tha "plisin" po muna me kajt ç'a më kallxojnë. "E heka plisin" tha, "hina në qufra, më gjetën në qufër, um thirrën o Zymer, o Zymer shkijet" tha, "me automat, deshtën" tha, "me më pushkatu" kishin pa kajt këto motrat e mia e lëshun, po (përlotet).

Anita Susuri: E mas luftës kur ju ka ardhë... me siguri në media e keni, e keni marrë vesh që u kry lufta...

Isuf Peci: Jo na e kena ditë kur i ka mshu NATO atë natë, e qiti CNN-i kurrë s'e harroj, tha, "Bombardimi u bo qetash" gjithë natën qut t'u kqyrë (përlotet). {ngrit duart} Ç'a me bo?

Anita Susuri: E kur kanë hi forcat e NATO-s në Kosovë?

Isuf Peci: Unë në Gjermani jom konë, s'jom konë këtu.

Anita Susuri: Qysh e keni prit qato?

Isuf Peci: *Aaa* {onomatope} veç e festojshim, dulëm në çarshi, na hetojshin gjermanët, thanë, "*Aaa* {onomatope} NATO, NATO" thashë, "NATO vallahi qetash" thashë, "boll mirë po ja bon", po qysh. Vallahi Zoti mos e huptë kurrë Amerikën se sot qitu as unë as ti s'ishim".

Anita Susuri: A ka pasë dëmtime në shpinë e juj a?

Isuf Peci: E kanë kall krejt, sot me shku veç zidnat jonë aty. Po munona najfarë bashçe në penzi po shkoj qatje, po rri qatje. Krejt zi, krejt i kanë sos, të parën shpi ma kanë kall mue, tim edhe po kallxon plaku rahmet shpirti i pastë tha, "E gjujke me nifarë pushke {bën sikur mban armë në dorë} *tak* {onomatope} qishtu, s'vanojke" tha, "veç kur i dalke..." çka kish çfarë plumbi nuk e di "flakë" tha "i shkojke". Po, po, qysh jo.

Anita Susuri: E sa kohë masi u kry lufta ju jeni kthy në Kosovë?

Isuf Peci: Valla 2002-tën, 2003-tën.

Anita Susuri: Pse jeni kthy?

Isuf Peci: Më kthyen, më kthyen vallahi. Se s'isha kthye nashta, po ma mirë që jom kthye se erdha qitu në "Trepçe" u punësova me 150 euro jom punësu ma së mrami, kurse në penzi jom shku me 95 euro se ma dhanë edhe vendin këtu, bukë bre kena pru. Kur jena ardhë mas lufte bukë, ka ni burek. Po a mahet shpirti me ka ni burek në minierë o vlla? U konë pa mush llastika plot qitu të burekave beso, a din. Po valla, po tash pak ma...

Anita Susuri: Këtu veç u stabilizu gjendja, mas luftës u konë shumë keq, u konë gati me u...

Isuf Peci: Me u fundos, po shoktë tonë i falenderoj tonë, jane ardhë kanë punu edhe pa rrogë tre mujë ditë, po ja u kishin pasë pague. Kanë punu pa rrogë, nuk e kanë lonë, kryesorja u konë mos me u fundos në ujë se m'i marrë ujët mo s'mun hin kërkush atje poshtë, pumpat.

Anita Susuri: Qysh ju ka vazhdu tani puna mas luftës?

Isuf Peci: Po filloi, gati si në fillim, m'u doke si në ondrra, si me konë në ondërr diqysh. Shkojsha i kqyrsha ata vena ku kom punu përpara me tjerë shokë, ata do s'jonë, do jonë dekë. M'u doke rondë m'u doke, diqysh shumë çpesh bile me thonë të vërtetën para ni viti a diçka më thirrën të nesërmen më çun me marrë qat' temë të diplomës, beso kur jom hi kajta atje se me sa njeri jom zbrit aty, me sa njeri kom nejt, sa hajgare në ato venat, thojsha, "O more Zot" a din rondë ish. Edhe u musha frymë po ma bojnë ata, "Hajde shkojna në punishte me inçizu atëherë te xehëtari", thashë, "Jo vallahi, dej te zyrja e vendit" aty ku ta jep orarin, thashë, "S'muna se mushna frymë" me kohë shkon kjo, me kohë shkon.

Anita Susuri: E mas luftës çfarë pozite e keni pasë këtu, a keni vazhdu...

Isuf Peci: E vazhdova qat' punën si mjeshtër dikur ma dhanë mjeshtër kryesor *poslovod*, i falenderoj edhe drejtorat këtu që ma dhanë, thanë, "Pec, e ke dhonë kontributin tond" tha, "qet pozitë po ta jepim udhëheqës". Po ka qenë edhe nuk di cili vit ka qenë që pat prishje këtu e patën metë minatorët pas lufte këtu në grevë, mrena u prish ashensori e më kanë thirrë mu. Une me inzhinjerin jena lidh e më kanë qit në kosh të xehës, ka tre vetë palut jena lëshu në konop, jom lidh në konop e më ka lëshue, o tmerr o me pa ato, kuku qysh osht' një mijë e kusur metra m'u lidh në konop osht' tmerr {dridh duart}.

Bile sot e atë ditë trupi më rrënqethët pat me u myt ai inzhinjeri, kur ja kom ngjit {bën sikur kap diçka me dorë} thashë, "O ra poshtë oj qyqe! Re poshtë". Sot më falenderon, pat me shku as copa... Kem raste këtu që, pak pare e ceka, shumë minatorë janë ra në shakt, nuk ka mujt asnjë me shku në dhetin, nimdhetin, ni komë i ka met në gjashtin, njo në pestin, osht' tmerr. E m'u lidhë në konop e me kqyrë atje, jom hi i kom pre ato i kom ngarkue krejt edhe sot e atë ditë s'kom marrë kurrfarë merite. Une me qat' inxhinjerin konop jom hi i kom lidh e i kom qit punëtorët që metën dy ditë e dy netë. Atë ditë kur jom konë krejt zi u konë prej SUP-i e këtu, thashë, "Veç mos ëm pengoni" thashë "largonu krejt" thashë. E kom bo lidhjen vet, me komandë, me mashinist i kom qit jashtë.

Anita Susuri: Edhe ni sen që deshta me ju vet për minatorët, që osht' puna e rondë edhe lypin ushqim ma të madh, ma, ma...

Isuf Peci: Ma të freskët...

Anita Susuri: Me qumsht, me...

Isuf Peci: Po, përpara... A e kryve? [i drejtohet bashkëbiseduese]

Anita Susuri: Po (qesh), s'ka problem, vazhdoni.

Isuf Peci: Përpara, po foli në kohë të okupimit, xehëtarët që jonë kanë në punishte kanë pasë edhe ni bon [per diem] ma tepri, ata e kanë pasë me marrë veç tomël për me ja pastru fytyrën {prek pjesën prej fytyrës e deri tek lundrat} prej mikrobeve, prej glukozës, prej pluhrit, e po u kanë ajo. Ushqimi, u kanë në nivel ushqimi edhe u kanë edhe restoranti u kanë, qyre u kanë nën kontroll, kanë kontrollu çka po ju qet punëtorëve, çka po hanë, çka po pijnë. A të vetmit e kanë pasë minatorët qat' bon, bile i kena thonë atëherë, për hajgare ja kena lonë "bon i qenit". Me qat' bon marrshin tepriçë, tjerët e kanë pasë ka ni bon ata e kanë pasë të veçantë edhe ni bon, po për shkak të kushteve të rona, të rrezikshmërisë e ma së shumti ju ka vyjt tomli, tomli e pastron po.

Anita Susuri: E familja juaj qysh e ka përjetu qet' punën e juaj që çdo ditë që keni shku keni qenë të rrezikuar gjithmonë, në çdo moment? Qysh jonë ni ata, për shembull fëmijë, grua a jonë tutë për juve?

Isuf Peci: Po me të thonë të vërtetën nuk jonë tutë, a di kur jonë tutë kur kanë thonë, "Ndodhi diçka në 'Trepçe'" e qat' herë e kanë pasë atë tutën ma të madhe kush osht' ai. Edhe tash, për shembull m'u kanë naj ndihmë e shpejtë me shku, une për veti jom qat, si të shoh menihërë thirrni nalt, "Kush u vra, kush u asi...?" Se na tërheqë ajo neve, na të lindne e kem ato. Bile ni rast mas lufte kur u kanë kjo Luljeta Pula, jo... qysh e ka pasë emrin kjo ministresh, e trashë u kanë në PDK u kanë, si hinëm në grevë këtu mas lufte e erdh këtu, thojshin, bile dul ni propagandë thanë, "Nuk p'i lojmë me dalë jashtë". E trashë u kanë, në fakulltet jep mësim aja, qysh e ka pasë emrin? U ikë tash ajo prej PDK-je më doket, profesoreshë osht'.

Edhe kur erdh atje, dul dikush tha, "S'pi lëshojnë minatorët pa i plotësu kushtet" e kishin rrejt mediat, dikush kish pasë rrejt, erdh aty u ngj. Po kur erdh u kanë qaq e trashë, kështu e musht ja nisi munim e kapke, tani ja nisëm na qysh e kem zanat me hajgare, se me hajgare e me bisedë, e me minatorë nuk ka në botë, le të thonë çka dojnë, nuk idhnohesh. Si të del në portë, si të del jashtë porte i harron ato. Kërkush mo nuk t'i përmend ashtu u kanë fjala. E tha, "Edhe në dekshë" tha "qitu", po ja harroj emrin asaj, "edhe në dekshë" tha "me juve du me dekë. S'po du me dalë". I thojshëm, "Dil se..." e pajshim i dhoshum ujë qishtu se munim a din. Tha, "Valla s'po dalë se kurrë në jetën time" tha, "qishtu" tha "me hajgare, me bisedë s'kom kalu". Po ja harroj emrin asaj në PDK u kanë e trash, osht' e musht... o në gojë e kom emrin e saj.

Anita Susuri: Nejse, s'o me rëndësi.

Isuf Peci: Po a din masi...

Anita Susuri: Nëse keni edhe diçka me shtu...

Isuf Peci: Jo, kurgjo.

Anita Susuri: Falemnderit shumë për intervistën, për kohën!

Isuf Peci: *Ihh* {onomatopea} çka të ka nevoj, çka di, çka s'harroj, muna me gabue, muna me... diçka, po me qëllim jo. Ju falenderoj edhe juve se ardhmëria jonë osht' në juve. E ishalla more Zot nuk shohum keq në juve, në fëmi. Edhe kom dëshirë m'u konë konkurent të Bashkimit Evropian ndër fëmitë, ndër mediat, ndër programet, në të gjitha të mirat barabartë me shtetet. Se na nuk jena mësu me pasë shtet, po kena qef m'u konë të barabartë me thonë unë jom Kosovë, me përfaqësu Kosovën si qysh duhet në mënyrë të drejtë. Qishtu, kurgjo, falemnderit edhe prej juve!

Anita Susuri: Falemnderit!